

LIGJ
Nr. 51/2017

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË PËR
PROGRAMIN “NË MBËSHTETJE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL (AFP)
NËPËRMJET INOVACIONIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për programin “Në mbështetje të arsimit dhe formimit profesional (AFP) nëpërmjet inovacionit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 13.4.2017

Shpallur me dekretin nr. 10221, datë 27.4.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
PUNËVE TË JASHTME DHE BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR
NË LIDHJE ME

**Programin në Mbështetje të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP)
nëpërmjet Inovacionit**

Qeveria e Republikës Italiane (QRI) dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (QRSH), të dyja të referuara bashkërisht si “Palët” dhe veçmas si “Palë”,

Duke marrë në konsideratë marrëdhënien reciproke të miqësisë;

Ndërsa më 11 dhjetor 2014, nga të dyja Qeveria e Republikës së Italisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, u nënshkrua Protokoll i Bashkëpunimit dhe Zhvillimit, 2014-2016;

Ndërsa Protokoll i lartpërmendur identifikon arsimin dhe trajnimin profesional nëpërmjet inovacionit si një mjet për zhvillimin e burimeve njerëzore, zhvillimin dhe kohezionin social e territorial;

Ndërsa për këtë Program është specifikuar një hua e butë pa përcaktim specifik prej 5 milion euro për Arsimit dhe Formimit Profesional nëpërmjet Inovacionit;

Ndërsa nga të dy Palët u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi në 22 Dhjetor 2015, që përshkruan logjikën kryesore të ndërhyrjes;

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizimi dhe Përmbajtja e Marrëveshjes

1.1 Kjo Marrëveshje përbëhet nga 15 nene dhe 3 Shtojca:

SHTOJCA 1 – Plani Financiar;

SHTOJCA 2 – Procedurat Zbatuese të Huas së Butë.

SHTOJCA 3 – Dokumenti i Formulimit të PROGRAMIT;

1.2 Shtojcat janë pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje.

1.3 Akronimet e përdorura në këtë Marrëveshje janë si më poshtë:

MARRËVESHJE	Kjo është Marrëveshje ndër-qeveritare ndërmjet Palëve për zbatimin e PROGRAMIT.
AIBZH	Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim
CDP	<i>Cassa Depositi e Prestiti</i> – Instituti Financiar Italian që menaxhon huan e butë.
KMRSH	Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë
QRI	Republika e Qeverisë Italiane
GIMP	Grupi i Integruar i Menaxhimit të Politikave
MAECI	Ministria Italiane e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar.
MF	Ministria Shqiptare e Financave
MMSR	Ministria Shqiptare e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
SKPA	Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, 2014-2020
PALËT	Qeveria e Republikës Italiane, e përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.
PROGRAMI	<i>Programi i Arsimit dhe Formimit Profesional nëpërmjet Inovacionit</i> në Shtojcën 3.
SC	Komiteti Drejtues
MKB	Marrëveshja e Huas së Butë. Marrëveshja Financiare ndërmjet Ministrisë shqiptare të Financave dhe <i>Cassa Depositi e Prestiti</i> .
AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional

Neni 2
Qëllimi i Marrëveshjes

2.1 Marrëveshja rregullon zbatimimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e procedurave të *Programit të Arsimit dhe Formimit Profesional nëpërmjet Inovacionit* (më poshtë i referuar si PROGRAMI).

2.2 Për këtë qëllim, Marrëveshja përcakton detyrimet e ndërsjella të Palëve në lidhje me PROGRAMIN, në veçanti për kushtet e huas së butë.

Neni 3
Përshkrimi i Programit

3.1 - PROGRAMI synon të përmbushë vizionin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA), 2014 – 2020, për të pasur një ekonomi konkurruese dhe një shoqëri gjithëpërfshirëse që mbështetet në aftësi më të larta dhe punësim më të mirë për të gjithë gratë e burrat deri në vitin 2020, në sektorët prodhues ku Shqipëria ka një potencial të madh dhe Italia ka një vlerë të shtuar të konsiderueshme.

PROGRAMI do të ketë katër rezultate të pritshme: i) organizimin dhe zhvillimin në mënyrë të plotë të Shkollës Bujqësore multifunkionale të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) në Fier dhe përmirësimin dhe riorganizimin e shkollës së AFP-së në Lushnjë; ii) zhvillimin dhe zbatimimin e kurrikulave të AFP-së të orientuara nga tregu; iii) ndërtimin e marrëdhënieve të qëndrueshme dhe të përshtatura sipas kushteve, ndërmjet shkollës multifunkionale të AFP-së dhe sektorit privat; iv) sigurimin e koherencës me financimin e IPA II për Sektorin e Punësimit dhe Aftësive.

3.2 - Shtojca 3 përmban një përshkrim të hollësishëm të PROGRAMIT.

Neni 4
Angazhimet e Qeverisë Italiane

4.1 - QRI do të sigurojë një hua të butë pa përcaktim specifik prej 5 milion Euro për realizimin e PROGRAMIT (Shtojca 3), sipas Planit Financiar (Shtojca 1), sipas Orientimeve për Zbatimimin e Projektit (Shtojca 2). Huaja do të përdoret për: i) Rehabilitimin e infrastrukturave; ii) Blerjen e mallrave (Pajisje & Laboratorë); iii) Asistencë Institucionale Teknike; iv) Asistencë për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nëpërmjet Grupit të Integruar të Menaxhimit të Politikave (GIMP) dhe Sekretariatit të saj Teknik. Huaja do të disbursohet sipas modaliteteve të përshkruara në nenin 7 dhe Shtojcën 2.

Neni 5
Angazhimet e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

5.1 - KMRSH do të garantojë zbatimimin e PROGRAMIT sipas kësaj Marrëveshjeje.

5.2 - KMRSH do të garantojë hyrjen në fuqi, para fillimit të PROGRAMIT, të një ligji të AFP-së ose akteve nënligjore ose akteve administrative duke siguruar autonomi financiare të shkollave AFP të Fierit dhe Lushnjës, përfshirë dhe mundësinë për të siguruar shërbime dhe për të shitur mallra tek palë të treta;

5.3 KMRSH do të garantojë hyrjen në fuqi, para fillimit të PROGRAMIT, të një ligji të AFP-së ose akteve nënligjore ose akteve të posaçme, duke mundësuar që të ofrohet niveli 5 i Kornizës Europiane të Kualifikimeve - KEK (arsimi pas nivelit të shkollës së mesme) në shkollën e AFP-së Fier.

5.4 - KMRSH do të garantojë bashkëpunimin me AIBZH-në mbi monitorimin e PROGRAMIT dhe aksesin tek dokumentet e PROGRAMIT.

5.5 - KMRSH do të shlyejë huan sipas kushteve të përcaktuara në Nenin 8.

Neni 6
Strukturat e Menaxhimit dhe Zbatimit të Programit

Strukturat e menaxhimit dhe zbatimit të PROGRAMIT përshkruhen në Shtojcën 3 dhe parashikojnë që:

6.1- MMSR është agjencia ekzekutuese dhe si e tillë, do të sigurojë që aktivitetet e PROGRAMIT të zbatohen sipas rregullave të Marrëveshjes së PROGRAMIT. MMSR do të jetë përgjegjëse për zbatimimin e Marrëveshjes së PROGRAMIT. MMSR do të jetë përgjegjëse edhe për zbatimimin e procedurave të tenderimit dhe për dhënien dhe mbikëqyrjen e punimeve, kontratat për pajisjet dhe shërbimet që janë pjesë e PROGRAMIT dhe që i ngarkohen Marrëveshjes së Huas së Butë. MMSR do të caktojë

përfaqësuesin e vet brenda KD-së.

6.2 - MF është autoriteti që përfaqëson Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë në lidhje me marrëveshjen e huas që do lidhet me CDP.

6.3 - MAECI është përgjegjëse për nënshkrimin e Marrëveshjes;

6.4 - AIBZH është përgjegjëse për monitorimin e PROGRAMIT. Ajo do të përfaqësojë QRI-në si për zbatimin e PROGRAMIT, duke vepruar nëpërmjet Zyrës së vet në Tiranë. AIBZH do të garantojë gjithashtu të gjitha funksionet e nevojshme teknike për zbatimin e duhur të të gjitha aktiviteteve të PROGRAMIT dhe do të sigurojë marrjen dhe transmetimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm administrativ. AIBZH do të përcaktojë përfaqësuesin e vet brenda KD-së.

6.5 - CDP është Banka Agjente italiane përgjegjëse për përgatitjen e MKB-së në bashkërendim me Ministrinë Italiane të Ekonomisë dhe Financave, dhe për nënshkrimin e MKB-së. MKB-ja është një marrëveshje financiare që rregullon përdorimin e huas së butë. CDP është gjithashtu përgjegjëse për çdo kontratë mbi MKB-në, siç përshkruhet në Shtojcën 3. CDP është përgjegjëse për pagesat e kontratave, sipas dispozitave të MKB-së.

6.6 Do të ngrihet një KD me qëllim që të sigurojë orientimin e përgjithshëm, koordinimin dhe mbikëqyrjen e plotë të aktiviteteve nën Programin e AFP-së. KD do të përbëhet nga përfaqësuesit e MMSR-së dhe AIBZH-së. Përfaqësuesit e Zyrës së Kryeministrit, si dhe Ministrive të tjera të linjës si Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Arsimit dhe Sporteve mund të ftohen të marrin pjesë dhe të ndjekin mbledhjet e KD-së.

Neni 7

Zbatimi i Procedurave të Huas së Butë

7.1 Procedurat e disbursimit, përdorimit dhe rimbursimit të huas do të përcaktohen nga një MKB e nënshkruar ndërmjet CDP-së dhe MF-së.

7.2 Fondet e huas do të disbursohen në dy modalitete të veçanta, në varësi të tipologjisë së shpenzimeve, siç përshkruhet në Shtojcën 2 bashkëlidhur.

7.3 Aktivitetet e prokurimit do të kryhen në përputhje me *Manualin Praktik aktual për procedurat kontraktuale të veprimave të jashtme të KE-së (PRAG-të)*. AIBZH do të japë aprovimin mbi:

i) dokumentet e tenderimit para publikimit dhe raportit të vlerësimit të tenderit para dhënies së kontratave për tendera, vlera e të cilave e kalon shumën 500.000 Euro për shërbime dhe pajisje dhe 1.000.000 Euro për punime;

ii) raportin e vlerësimit të tenderit para dhënies së kontratave për tendera midis 130.00 Euro dhe 500.000 Euro për shërbime dhe pajisje dhe për tendera midis 200.000 Euro dhe 1.000.000 Euro për punime.

7.4 Aktivitetet e auditimit mbi bazë vjetore do të kryhen në kuadër të procedurave të auditimit nga një shoqëri e përzgjedhur nga KMRSH ndërmjet atyre të cilat janë miratuar nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC) dhe në përputhje me Standardet e Auditimit INTOSAI, në kuadrin e procedurave të auditimit nga Ministria e Financave të projekteve me financim të huaj. Kostoja e procedurave të auditimit do të mbulohet nga Ministria e Financave jashtë fondeve të programit.

7.5 Shpenzimet që sipas raportit të auditimit nuk janë të justifikuar, do të konsiderohen të pavlefshme sipas kësaj Marrëveshjeje dhe burimet përkatëse duhet të ririfinancohen nga KMRSH.

Neni 8

Termet dhe Kushtet e Huas

8.1 QRI do t'i japë KMRSH-së një hua të butë pa përcaktim specifik prej 5 milion Euro.

8.2 Huaja e Butë ka një *komponent granti* prej 60% që i korrespondon:

i. normës së interesit: 0%;

ii. afatit të shlyerjes: 22 vjet;

iii. periudhë tolerimi pagese: 10 vjet.

Neni 9

Monitorimi i Zbatimit

9.1 Çdo gjashtë muaj, MMSR do të përgatisë një raport teknik dhe financiar që i paraqiten Ministrisë

së Financave dhe palës italiane dhe do të miratohet nga KD. Raporti i parë i Progresit do të paraqitet gjashtë muaj pas disbursimit të kështit të parë të financimit.

9.2 AIBZH do të monitorojë PROGRAMIN nëpërmjet Zyrës së vet të Bashkëpunimit në Tiranë dhe me misionet *të posaçme* nga zyra qendrore.

9.3 Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm do të realizohet në kuadrin e një sistemi të përbashkët monitorimi dhe vlerësimi të rënë dakord në një Memorandum të veçantë Mirëkuptimi me Delegacionin e Bashkimit Europian në Shqipëri përgjegjës për mbështetjen buxhetore në sektorin e AFP-së.

Do të kryhet gjithashtu një monitorim dhe vlerësim i sistematizuar nëpërmjet mbështetjes për PROGRAMIN tek Sekretariati Teknik i Grupit të Integruar të Menaxhimit të Politikave (GIMP) në Sektorin e Politikave Sociale dhe Punësimit.

9.4 Do të kryhet një vlerësim i mëpasshëm pas përfundimit të PROGRAMIT. Ky vlerësim do të kryhet bashkërisht nga të paktën dy ekspertë të pavarur, një i caktuar nga qeveria italiane dhe një nga qeveria shqiptare, ku secila Palë mbulon kostot e ekspertit të vet.

Neni 10

Klauzola Anti-Korrupsion

Qeveria e Republikës italiane është e angazhuar në luftën kundër korrupsionit në të gjitha format. Në veçanti, për të shmangur ndonjë mundësi të aktiviteteve të paligjshme dhe parregullsive në aplikimin për tendera për pajisje, shërbime dhe punime civile, Qeveria italiane ka prezantuar një detyrim për të gjithë ofertuesit për tender që të nënshkruajnë dhe të paraqesin një *Pakt Integriteti* së bashku me ofertat e tyre apo kontratat e miratuara. Mosparaqitja e një dokumentacioni të tillë do të përjashtojë automatikisht ofertuesin nga konkurrimi. Në rast të mospërbushjes së angazhimeve antikorrupsion gjatë ekzekutimit të kontratës, do të zbatohen sanksionet përkatëse. Përfshirja e një klauzole të tillë synon të sigurojë një konkurrim të ndershëm dhe mundësi të barabarta për të gjithë pjesëmarrësit, si dhe një zbatim të duhur dhe transparent të kontratës së miratuar.

Neni 11

Mosmarrëveshjet

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë zbatimit të Programit do të zgjidhet në mënyrë miqësore nëpërmjet konsultimeve midis MMSR-së dhe AIBZH-së.

Neni 12

Pengesat dhe Forcat Madhore

Në rast të pengesave për zbatimin e Programit, për shkak të *forcave madhore* (luftë, përmytje, zjarr, tajfun, tërmet, konflikte pune, greva, vështirësi të paparashikuara në transport dhe shkaqe të tjera) të njohura nga të dyja Palët, ose në rast rreziku ose kushteve të rrezikshme për personelin e huaj, do të miratohen procedurat e mëposhtme:

12.1 Nëse kohëzgjatja e pengesës për realizimin e PROGRAMIT është më pak se gjashtë muaj, përdorimi i fondeve të paangazhuara do të pezullohet derisa AIBZH të autorizojë rifillimin e aktiviteteve;

12.2 Nëse pengesa zgjat më shumë se gjashtë muaj dhe më pak se njëzet e katër muaj, PROGRAMI pezullohet dhe fondet e paangazhuara mbahen deri sa të marrë fund pengimi, dhe deri në marrjen e autorizimit të rifillimit të aktiviteteve nga AIBZH;

12.3 Nëse kohëzgjatja e pengesës është më e madhe se njëzet e katër muaj, Palët do të bien dakord nëse duhet të vazhdojnë apo të përfundojnë Programin. Në rast pamundësie për vazhdimin e aktiviteteve, Palët duhet të vendosin mbi destinacionin e fondeve të paangazhuara. Në mungesë të një marrëveshjeje, pala shqiptare merr përsipër të shlyejë shumat e mbetura në fonde që i transferohen MMSR-së sipas Nenit 7.

Neni 13

Përfundimi i Marrëveshjes

Palët rezervojnë të drejtën të përfundojnë këtë Marrëveshje në rastet e mëposhtme:

13.1 KMRSH nuk arrin të përmbushë angazhimet e përmendura në nenin 5;

13.2 Shkelje të rënda të MMSR-së, të tilla si vonesa të gjata dhe të pajustificuara (më shumë se nëntë

muaj) që mund të pengojnë zbatimin e PROGRAMIT, përdorimi i fondeve për arsye të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë Marrëveshje dhe në MKB, vonesë e zgjatur për paraqitjen e raportimeve që referohen në nenin 9;

13.3 Pengesë e zgjatur apo forcë madhore, siç përcaktohet në klauzolat e Nenit 12 më sipër;

13.4 Në rast të shkeljeve të rënda sipas pikës 13.2, QRI do të njoftojë për incidentin dhe do të ftojë MMSR-në të marrë të gjitha masat e nevojshme brenda maksimumi 90 ditësh nga data e periudhës së njoftimit. Pas këtij afati, QRI rezervon të drejtën të përfundojë këtë Marrëveshje;

13.5 Në dy rastet e lartpërmendura, QRI mund të vendosë në mënyrë të njëanshme të përfundojë këtë Marrëveshje që do të njoftohet nëpërmjet një Note Verbale për MMSR-në të paktën tre muaj para. Në çdo rast, pas këtij njoftimi, MMSR është e detyruar të ndërpresë aktivitetet e PROGRAMIT, nëse Palët nuk bien dakord ndryshe.

Neni 14

Ndryshimi i Marrëveshjes

Palët mund të propozojnë, në çdo kohë, amendime në përmbajtjen e kësaj Marrëveshjeje me anë të shkëmbimit të Notave Verbale, nëpërmjet kanaleve diplomatike. Amendimet për të cilat Palët do të bien dakord eventualisht, do të hyjnë në fuqi në përputhje me procedurat e brendshme të nevojshme.

Neni 15

Hyrja në Fuqi dhe Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi datën e marrjes së njoftimit të dytë nga dy njoftimet me të cilat Palët Kontraktuese kanë njoftuar zyrtarisht përfundimin e procedurave të tyre përkatëse të brendshme.

Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi deri në shlyerjen e plotë të huas së butë.

NË DËSHMI TË KËSAJ, të nënshkruarit, autorizuar sipas rregullave nga Qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në _____, më _____, në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

Për Qeverinë
e Republikës Italiane

Për Këshillin e Ministrave të
Republikës së Shqipërisë

SHTOJCA 1

PLANI FINANCIAR

Plani Financiar			Shuma (në euro)	Fier	Lushnjë	Komponentët e Projektit (A=Infrastruktura; B=Laboratorë & Pajisje; C=Asistencë Teknike Institucionale; D= asistenca e MMSR
		Rezultati 1	3.755.000,00			
1.1	1.1.1	Identifikimi i punimeve	25.200,00	12.600,00	12.600,00	A

	1.1.2	Zhvillimi i Konceptit Infrastrukturor të Projektit	40.000,00	30.000,00	10.000,00	A
	1.1.3	Përgatitja dhe redaktimi i dokumentacionit të tenderimit	25.200,00	12.600,00	12.600,00	A
	1.1.4	Kontrata e punimeve, e nënshkruar dhe e zbatuar	1.122.600,00	1.000.000,00	122.600,00	A
	1.1.5	Mbikëqyrja e punimeve	40.000,00	30.000,00	10.000,00	A
	1.1.6	Testimi përfundimtar	10.000,00	5.000,00	5.000,00	A
1.2	1.2.1	Përgatitja dhe redaktimi i dokumentacionit të tenderimit	40.000,00	30.000,00	10.000,00	B
	1.2.2	Kontrata e furnizimit për blerjen e laboratorëve dhe pajisjeve	1.400.000,00	1.250.000,00	150.000,00	B
	1.2.3	Kontrata e furnizimit për blerjen e makinerive, automjeteve bujqësore dhe mjeteve bujqësore	400.000,00	350.000,00	50.000,00	B
	1.2.4	Kontrata e furnizimit për blerjen e mobilieve	200.000,00	170.000,00	30.000,00	B
	1.2.5	Kontrata e furnizimit për blerjen e materialit didaktik	200.000,00	180.000,00	20.000,00	B
1.3		Bordi i Direktivës së Shkollës	126.000,00			C
1.4		Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	25.200,00			C
1.5		Programi për Trajnimin e Përgjithshëm	25.200,00			C
1.6		Shërbim Karriere	25.200,00			C
1.7		Garantim Cilësie	25.200,00			C
1.8		Akreditim dhe certifikim	25.200,00			C
		Rezultati 2	151.200,00			
2.1		Zhvillimi dhe përcjellja e kurrikulës së nivelit të shkollës së mesme	37.800,00			C
2.2		Zhvillimi dhe përcjellja e kurrikulës afatshkurtër	37.800,00			C
2.3		Zhvillimi dhe përcjellja e kurrikulës së nivelit pas shkollës së mesme	37.800,00			C
2.4		Trajnimi i trajnerëve	37.800,00			C
		Rezultati 3	201.600,00			
3.1		Shërbime shkolle për palë të treta	126.000,00			C
3.2		Pilotimi i TAFPEP	75.600,00			C
		Rezultati 4	892.200,00			
4.1		Menaxhimi i Programit				
4.1.1		Menaxher Projekti	72.000,00			D
4.1.2		Drejtuuesi i Projektit (Ndërkombëtar)	216.000,00			C
4.1.3		Asistent projekti	28.800,00			C
4.1.4		Financier/administrativ	46.800,00			C
4.1.5		Teknik/agronom	36.000,00			C
4.1.6		Oficer për ndërlidhjen shkollë - ndërmarrje	36.000,00			C

4.1.7		Përkthyes	28.800,00			C
4.1.8		Shofer/asistent logjistik	21.600,00			C
4.1.9		Blerje makine	25.000,00			C
4.1.10		Mirëmbajtje makine	18.000,00			C
4.1.11		Materiale zyre dhe pajisje pune	14.000,00			C
4.1.12		Bileta udhëtimi	43.200,00			C
4.2		Shërbime Teknike				
4.2.1		Këshilltari rezident i bashkëpunimit (ndërkombëtar)	216.000,00			C
4.3		Shërbime prokurimi				
4.3.1		Oficer prokurimi	54.000,00			D
4.4		Strategjia e Komunikimit dhe veprime vizibiliteti				
		Oficer komunikimi	36.000,00			D
TOTALI			5.000.000,00			

SHTOJCA 2

PROCEDURAT ZBATUESE TË HUAS SË BUTË

Fondet e huas do të disbursohen në dy modalitete të ndryshme në varësi të tipologjisë së shpenzimeve:

I. Fondet e huas të “Komponentëve A, B dhe C” të Shtojcës 1 do të kreditohen si më poshtë:

i) Secila kontratë e nënshkruar ndërmjet Kontraktuesve dhe MMSR-së duhet të dërgohet tek zyra qendrore e AIBZH-së në Romë, nëpërmjet zyrës së AIBZH-së në Tiranë, së bashku me një deklaratë angazhimi të MMSR për të mbuluar të gjitha kostot përkatëse lokale (taksa e vlerës së shtuar, tarifrat doganore etj.).

ii) Me marrjen e dokumentacionit, AIBZH do të japë aprovimin për CDP-në. Si rrjedhojë, CDP do të informojë MMSR-në që do t'i kërkojë CDP-së të bëjë fondet të disponueshme.

iii) Në momentin e marrjes të të gjithë dokumentacionit të referuar në paragrafët e mësipërm ii) dhe ii), CDP do t'ia ngarkojë çdo kontratë MKB-së, duke informuar MF-në dhe MMSR-në. Plotësimi i kësaj procedure do të mundësojë “pagesat paraprake” të parashikuara në çdo kontratë dhe do të përcaktojë datën e tyre efektive të fillimit.

iv) Pagesat e mëposhtme do të kryhen në bazë të aprovimit nga MMSR dhe në përputhje me modalitetet e parashikuara në secilën kontratë.

II. Fondet e huas së “Komponentit D” të Planit Financiar (Shtojca 1) do të kreditohen në një transh të vetëm në një llogari të veçantë në Euro të titulluar “*Arsimi dhe Formimi Profesional nëpërmjet Inovacionit*”, hapur në emër të Ministrisë së Financave tek Banka e Shqipërisë.

Disbursimi i parë në lidhje me Komponentët A, B dhe C dhe disbursimi i vetëm i Komponentit D do të bëhen në bazë të përmbushjes së kushteve të mëposhtme:

- i) hyrja në fuqi e MKB-së;
- ii) ngritja e KD-së;
- iii) përzgjedhja e një firme auditimi dhe marrja e miratimit të AIBZH-së;
- iv) hyrja në fuqi e një ligji të AFP-së ose akteve nënligjore/akteve të posaçme të AFP-së që garantojnë autonomi financiare të shkollave të AFP-së në Fier dhe Lushnje, duke përfshirë dhe mundësinë e ofrimit të shërbimeve dhe shitjes së mallrave tek Palë të treta;
- v) hyrja në fuqi e një ligji të AFP-së ose akteve nënligjore/akteve të posaçme të AFP-së, duke mundësuar ofrimin e nivelit 5 të Kornizës Europiane të Kualifikimeve - KEK (arsimi pas nivelit të shkollës së mesme) në shkollën e AFP-së Fier.
- vi) përzgjedhja e institutit të Asistencës Teknike (Komponenti C) dhe marrja e aprovimit nga AIBZH.
- vii) përzgjedhja e personelit nën Komponentin D.

SHTOJCA 3

PROGRAM NË MBËSHTETJE TË ARSIMIT DHE TRAJNIMIT PROFESIONAL NËPËRMJET INOVACIONIT

Dokumenti i Formulimit të Programit Tiranë, shkurt 2016

Lista e Akronimeve

KSHK	Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
MBP	Marrëveshja Bilaterale për Programin
KiM	Këshilli i Ministrave
DPZHFNH	Departamenti Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj
DPBZH	Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim
BE	Bashkimi European
KEK	Korniza Europiane e Kualifikimeve
ETF	<i>European Training Foundation</i> (Fondacioni European i Trajnimit)
IHD	Investimet e Huaja Direkte
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
ARRPKK	Analiza e Risqeve dhe Pika Kritike e Kontrollit
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
IDC	<i>Italian Development Cooperation</i> (Bashkëpunimi Italian për Zhvillim)
IBD	Investimet e Brendshme Direkte
INSTAT	Instituti i Statistikave
IPA	<i>Instrument for Pre-Accession</i> (Instrumenti për Para-Anëtarësimin)
MID	Menaxhim i Integruar i Dëmtuesve
GMIP	Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave
SIBZHR	Strategjia e Integruar për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
MIPJBN	Ministria Italiane e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar
OZHM	Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
QMF	Qendër Multifunkionale e Arsimit dhe Formimit Profesional
MM	Memorandum Mirëkuptimi
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit

MMSR	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
AKAFPK	Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
SHKP	Shërbimi Kombëtar i Punësimit
NESS	Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi
OJQ	Organizatë Joqeveritare
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2007-2013)
OECD	<i>Organization for Economic Cooperation and Development</i> (Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim)
MKB	Marrëveshja për Kredinë e Butë
ANA	Analiza e Nevojave të Aftësive
KD	Komiteti Drejtues
PTAFP	Pakti Territorial për AFP
UNDP	<i>United Nation Development Programme</i> (Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara)
NJLT	Njësia Lokale Teknike e IDC në Tiranë
AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional
SHMP	Shkollat e Mesme Profesionale
QFP	Qendrat e Formimit Profesional
BB	Banka Botërore

Përmbledhja

Ekzekutive

Brenda kuadrit të dakordësuar të Protokollit të Bashkëpunimit për Zhvillim për periudhën 2014-2016 mes qeverive italiane dhe shqiptare, nënshkruar në Dhjetor 2014, dhe referuar Kolonës së Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI)¹ “*Investimi në Njerëz dhe Kohëzion Social*”, është rënë dakord nga të dy palët për të adresuar çështje që kanë të bëjnë me zhvillimin e burimeve njerëzore, veprimeve për kohezion territorial dhe përfshirje sociale. Në këtë kontekst, është menduar një alokim domethënës prej **5 milion euro** (kredi e butë) për të mbështetur ***Arsimin dhe Formimin Profesional nëpërmjet Inovacionit***, për të realizuar vizionin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim (SKPA) 2014 - 2020 me synimin për të pasur një ekonomi konkurruese dhe një shoqëri gjithëpërfshirëse që bazohet në aftësi në nivel më të lartë dhe punë më të mira për gjithë gratë e burrat deri në 2020.

Siç është rënë dakord nga të dy palët, Programi AFP i identifikuar do të mbështesë zgjerimin e një shoqërie të bazuar në dijen në përputhje me kërkesat e tregut të punës për të tërhequr IHD/IBD në sektorët produktivë, ku, si Shqipëria ka një potencial të madh dhe Italia ka një vlerë të shtuar të rëndësishme, të tilla si zhvillimi bujqësor e rural dhe përpunimi agro-ushqimor.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) është përgjegjëse për të menaxhuar sistemin e Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) si për të rinj edhe për të rritur, që përfshin të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe është e angazhuar për të përmirësuar cilësinë dhe të rrisë mbulimin e AFP multifunksional, edhe referuar zonave rurale.

Duke marrë në konsideratë faktin që bujqësia vazhdon të jetë sektori që mban “të punësuar” shumicën e popullsisë shqiptare, me afërsisht 41.3%, MMSR identifikon nevojën për ndërtimin e një shkolle AFP multifunksionale të zhvilluar plotësisht në sektorët e bujqësisë dhe përpunimit agro-ushqimor.

Programi për AFP do të konsistojë në ndërtimin e një shkolle AFP bujqësore multifunksionale, të nivelit ekselent në shkollën “Rakip Kryeziu” në Fier dhe në ndërhyrjet e përpikta në Shkollën e mekanikës bujqësore në Lushnje, përfshirë edhe asistencën financiare për zhvillimin e kurrikulave dhe në sigurimin e mbështetjes teknike dhe profesionale të MMSR.

Ambientet ekzistuese të shkollave AFP në Fier dhe Lushnje do të sigurohen nga pala shqiptare, me qëllim që të rehabilitohen, të përshtaten cilësisht, të integruara me ambientet rezidenciale për

¹ Referencë për draftin më të fundit të disponueshëm të SKZHI, datë Gusht 2015.

nxënësit dhe personelin, të plotësuar me mobilie dhe pajisje teknike për laboratorët, punishtet, magazinat, serrat, stallat, pularitë, fabrikat e përpunimit agro-ushqimor. Do të sigurohen nga Programi edhe gjëra shtesë si libra, mjete didaktike, makineri të mekanizuara, vegla në lidhje me këto, pajisje zyre, si dhe mbështetje teknike institucionale dhe financiare, për përcaktimin e sfera të mësimdhënies dhe kurrikulave dhe ngritjen e fermës demonstruese në Fier dhe magazinave në Lushnjë.

Katër komponentët e identifikuar të Programit të AFP janë si më poshtë:

A. Rehabilitimi i infrastrukturës; ky komponent lidhet me zbatimin e punimeve ndërtimore; këto konsistojnë në rehabilitimin e ambienteve ekzistuese për aktivitetet mësimore, punishtet, magazinat, për administratën dhe ambientet, ndërsa ndërtimet e reja do të shërbejnë për konvikte, laboratorë, magazina, fabrika përpunimi dhe pjesë shërbimesh; mund të përmirësohen gjithashtu edhe ambientet e jashtme;

B. Blerje mallrash (Pajisje & Laboratore): pajisje teknike dhe didaktike, makineri dhe njësi bujqësore, mobilie, pajisje zyre, libra dhe të gjitha mallrat e parashikuar për tenderim nën Programin AFP;

C. Asistencë institucionale teknike: për të siguruar funksionimin e duhur të shkollave AFP që janë objekt i Programit, si dhe do të sigurohet për shkollat e AFP-së një asistencë teknike institucionale e shkëlqyer, bazuar në eksperiencat më të mira të BE-së në sektorin e AFP-së, sidomos në ato që janë më afër me kontekstin shqiptar; termat e referencës detajohen në dokument;

D. Asistencë për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë: për të orientuar dhe monitoruar zhvillimin e politikave, zbatimin e strategjisë dhe vlerësimin e saj, prokurimet, komunikimin si në forcimin e koordinimit të donatorëve dhe sektorit nëpërmjet Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) dhe Sekretariatit të tij Teknik, sidomos për sa i përket planifikimit të sektorit, programimit dhe buxhetimit.

Programi i AFP do të ketë një kohëzgjatje totale prej tre vjetësh.

1. Hyrje

Qeveria shqiptare dhe qeveria italiane kanë rënë dakord për një Protokoll të ri të Bashkëpunimit për Zhvillim për periudhën 2014-2016, nënshkruar në Dhjetor 2014, që kryesisht u adresohet tre shtyllave të SKZHI dhe prioriteteve strategjike:

Rritje e qëndrueshme nëpërmjet përmirësimit të konkurrueshmërisë dhe përdorimit eficient të burimeve, me vëmendje të veçantë për të rritur *Konkurrueshmërinë dhe Inovacionin për Rritje* në sektorë kyç të ekonomisë përfshirë Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural;

Qeverisje e mirë, Demokraci dhe Sundim i Ligjit. Duke njohur vlerën e parimeve evropiane të subsidiaritetit dhe të afërsisë së ofrimit të shërbimeve të sektorit publik, IDC do të mbështesë reformën administrative territoriale të qeverisë shqiptare që po realizohet aktualisht me qëllimin për të konsoliduar Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV);

Investimi në njerëz dhe në Kohezionin Social do të fokusohet kryesisht në zhvillimin e burimeve njerëzore, veprime në funksion të përfshirjes sociale dhe kohezionit territorial, mes të cilëve është rënë dakord që një alokim prej 5 milion euro (kredi e butë) të mbështesë **Arsimin dhe Formimin Profesional nëpërmjet Inovacionit**. Specifikisht, Programi i financuar nga IDC do të fokusohet në mbështetjen për zgjerimin e një shoqërie të avancuar të bazuar në dijen në përputhje me kërkesat e tregut të punës për të tërhequr IHD/IBD në sektorët produktivë ku, si Shqipëria ka një potencial të madh, edhe Italia ka një vlerë të shtuar të rëndësishme (d.m.th. turizëm, industri mode, mobiliери, përpunimi agroushqimor etj.).

Në vijim të nënshkrimit të Protokollit, janë organizuar mbledhje dypalëshe mes Autoriteteve shqiptare përgjegjëse (Departamentit të Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj –DPZHFNH- të Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë-MMSR) dhe Zyrës së IDC (NJLT) në Tiranë me synimin për të lançuar fazën e përgatitjes së **Programit Arsimit dhe Formimit Profesional nëpërmjet Inovacionit** (që në vijim do të quhet “**Programi AFP**”). Si rezultat i këtyre takimeve, dhe me synimin që të identifikohet qëllimi i përgjithshëm, objektivi specifik, rezultatet e pritshme dhe aktivitetet e Programit AFP dhe të shtrohet rruga për fazën vijuese të formulimit për të konceptuar në mënyrë sa më eficiente Programin AFP, është përgatitur në mënyrë të përbashkët një **Memorandum Mirëkuptimi** (MM) për të cilin është rënë dakord mes MMSR dhe IDC-së.

Pikat kryesore të MM janë: i) një hyrje për kontekstin e përgjithshëm të zhvillimit në Shqipëri, ii) një prezantim përmbledhës i strategjisë së Qeverisë për Punësim dhe Aftësi; iii) një shikim i përgjithshëm i

protokollit dypalësh Italo - Shqiptar 2014 - 2016 për sa lidhet me Arsimin dhe Formimin Profesional; iv) arsyetimi për Programin AFP, objektivat, rezultatet dhe aktivitetet; v) një plan financues indikativ; vi) një hipotezë e rregullimit institucional për zbatimin e Programit; vii) një kalendar paraprak për hapat e mëtejshëm.

U realizuan vizita të përbashkëta identifikimi në rajonin e Fierit në 9 dhe 10 dhjetor 2015, në nivelin e studimit të parafizibilitetit, në bashkëpunim të ngushtë nga MMSR dhe Zyra e IDC (NJLT) me qëllim që të përcaktohen në mënyrë të përbashkët sferat e ndërhyrjes dhe komponentët brenda Programit AFP, objektivat, rezultatet dhe të gjitha aktivitetet kryesore dhe një alokim indikativ i buxhetit. Rezultati i kësaj faze është Dokumenti aktual i Formulimit.

Ky Dokument Formulimi merr në konsideratë iniciativat që po zhvillohen aktualisht në sektorin e AFP-së dhe informacionin e disponueshëm mbi kuadrin e përgjithshëm përkundër Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014 - 2020 (SKPA) dhe Dokumentit Indikativ të Strategjisë IPA II që përcakton prioritetet për asistencën financiare të BE-së për periudhën 2014 - 2020 në mbështetje të Shqipërisë në rrugën drejt hyrjes në BE, dhe më specifiku, Mbështetjen Buxhetore Sektoriale për Punësimin dhe Aftësitë. Ndërhyrjet e identifikuar do të adresojnë: i) shkolla të arsimit të mesëm; ii) kurse trajnimi afat-shkurtra; iii) trajnim dhe arsim post-sekondar (mbi bazë pilotimi deri sa të aprovohet ligji i ri i AFP-së dhe aktet respektive nënligjore). Përderisa arsimi post-sekondar është një nga forcat kryesore shtytëse të ndryshimit për zgjerimin e shoqërisë së avancuar bazuar në dije, në përputhje me kërkesat e tregut të punës për të tërhequr Investimet Direkte të Huaja dhe të Brendshme (IHD/IBD) në Shqipëri, i është dhënë vëmendje speciale programeve të sipërpërmendura të AFP-së. Në fakt, programet e arsimit post-sekondar të AFP-së duket se janë niveli më i përshtatshëm për të pilotuar një sistem dual efektiv në bujqësi dhe në sektorin e përpunimit agrorshqimor, dhe mund të përfaqësojnë një efekt ngritje të jashtëzakonshëm për të zhvilluar të gjithë politikën e qendrave multifunksionale të AFP-së.

Dokumenti aktual i Formulimit paraqet objektivat e përgjithshme dhe specifike, rezultatet e pritshme, aktivitetet e identifikuar dhe alokimin e buxhetit rënë dakord nga të dyja palët për zbatimin e Programit AFP në mbështetje të Arsimit dhe Formimit Profesional nëpërmjet Inovacionit brenda Protokollit Italo - Shqiptar 2014 - 2016.

1. Analiza e situatës

2.1 Ekonomia shqiptare

Gjatë viteve të fundit Shqipëria ka mbetur një nga ekonomitë në rritje në Europë. Rritja ka qenë rezultat i transformimeve strukturore, bazuar gjerësisht në lëvizjen e punës nga punësimet bujqësore me produktivitet të ulët në shërbime, ndërtim, dhe në një shkallë më të vogël – në prodhim industrial. Në periudhën 2001 - 2011, Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) për banor u rrit dy herë (deri në US\$4,555) duke arritur në nivelin e 31 për qind të mesatares së Bashkimit Europian.² Kjo rritje ekonomike u shoqërua me politika fiskale dhe makroekonomike stabël, reforma strukturore për të përmirësuar mjedisin e biznesit dhe investimet në infrastrukturë, teknologji dhe burime njerëzore. Si rezultat, produktiviteti i punës u rrit me një mesatare prej 6.4 për qind në bazë vjetore.

Në Diagnozën e vet për vendin në 2015, Banka Botërore nënvizon se Shqipëria *“duke e kapërcyer 6% për vit mesatarisht, ishte ekonomia rritëse më e shpejtë në Europë në dekadën që çoi drejt krizës financiare globale në 2008. [...] Kjo performancë e fortë rritjeje nënkuptonte që Shqipëria, që ishte vendi më i varfër i Europës në fillim të viteve 1990, arriti një status me të ardhura mesatare në 2008. [...] Në vitet e lulëzimit ndërmjet 2002 dhe 2008, rritja ngriti shumë njerëz prej varfërisë, dhe shkalla e varfërisë u ul nga 25.4 për qind në 12.5 për qind. Rritja ekonomike ishte gjithëpërfshirëse, me konsum mes 40 për qind të pjesës së poshtme në shpërndarjen e popullsisë (40 përqindshi i poshtëm) që u rrit më shpejt se mesatarja për vendin.”*³

Rritja u inkurajua në shkallë të madhe nga konsumi i brendshëm në rritje, kryesisht i përcaktuar nga hopi i lulëzimit në pronat pasuri e patundshme, dhe nga remitancat e emigrantëve, me një zhvendosje nga bujqësia rurale në sektorët urbanë. Megjithatë ky ndryshim në strukturën e ekonomisë nuk çoi drejt një rritje në produktivitetin total, që ka qenë në stanjacion që nga viti 2000, dhe në punësimin formal që

² INSTAT, *Prodhimi i Brendshëm Bruto në Republikën e Shqipërisë*, Gusht 2012 tek http://www.instat.gov.al/media/101280/llogarite_rajonale_4faqeshi_ang_.pdf; World Bank, *World development indicators (Treguesit e zhvillimit botëror)*, 2001-2010, tek <http://data.worldbank.org/data-catalog>; EUROSTAT, *News release 97/2012*, tek http://epp.eurostat.ec.europa.eu/cache/ITY_PUBLIC/2-20062012-AP/EN/2-20062012-AP-EN.PDF.

³ Grupi i Bankës Botërore, Prill 2015, Shqipëria e Brezit Tjetër – Një diagnozë sistematike e vendit, p. i.

ra nga 73% në 2000 tek 58% në 2008.

Pas krizës ekonomike globale, “Rritja ekonomike e Shqipërisë pati një mesatare nën 3% në vit në terma realë ndërmjet 2009 dhe 2012, duke u zhytur tek një mesatare prej vetëm 1.7% në vit në 2013 dhe 2014.”⁴ Impakti i krizës rezultoi në rrudhjen e kërkesës për forcë punëtore dhe shkalla e varfërisë qëndroi tek 14.3% në 2012. Në 2013, me 7% të popullsisë që jetonte nën nivelin e varfërisë prej \$2.50 në ditë, Shqipëria ishte vendi i katërt më i varfër në Europë⁵. Kriza e vitit 2008 nxori në pah kufizimet e modelit të rritjes që varej nga flukset e huajani konsum të brendshëm financiar, investim dhe në fund rritje.

Është bërë e nevojshme një politikë shumëplanëshe për të riorientuar ekonominë drejt sektorëve inovatorë dhe produktivë nëpërmjet: i) një klime biznesi të cilësisë së lartë, rritjes solide dhe krijimit të vendeve të punës; ii) infrastrukturave të përshtatshme fizike; iii) **përmirësimit të cilësisë së burimeve njerëzore, që të arrijë në nivel të nevojave për sektorët inovatorë, me një forcë punëtore me aftësi të shkallës së lartë**; iv) mundësia dhe prania e shërbimeve të duhura të biznesit dhe instrumente financiare mbështetëse⁶.

Marrja e masave për inovacion është thelbësore për të tërhequr Investime e Huaja Direkte (IHD) në sektorë që kanë më shumë vlerë të shtuar,⁷ për të inkurajuar Investimet e Brendshme Direkte (IBD), për të promovuar inovacionin produkt/proces, hapjen e bizneseve të reja, përballimin e sfidave të një tregu të hapur dhe reduktimin e papunësisë së të diplomuarve të rinj.

2.2 Tregu i punës⁸

Rritja ekonomike e regjistruar gjatë dekadës së fundit pati një impakt të kufizuar në punësim. Bujqësia mbetet akoma operatori kryesor i punësimit, ndonëse pati një tendencë ulëse krahasuar me vitin 2000. Në 2012, sektori bujqësor regjistronte 47.4 për qind të punësimit total, dhe sidomos për gratë (58.4 për qind e grave të punësuar punonin në bujqësi krahasuar me shifrën 43.1 për qind të meshkujve). Punësimi në sektorin e shërbimeve përfaqëson 36.1 për qind të punësimit total, ndërsa industria punëson 16.5 për qind të të gjithë punëtorëve, dhe meshkujt figuronin në shifra dy herë më të larta për punësim në industri krahasuar me gratë.⁹

Shkalla e papunësisë është rritur më tej në 17.9 % në 2014, dhe shumica e personave të papunë rezultojnë se kanë nivele të ulëta arsimimi. Ndër grupmoshën 15 - 29 vjeç, shkalla e papunësisë shkon deri në 32.5 % (16.4% meshkuj/23.6% femra). Në lidhje me çështjet gjinore, ka akoma diferenca të konsiderueshme gjinore në tregun shqiptar të punës, mesatarisht, hendeuku është rreth 15 pikë për punësimin e femrave dhe meshkujve¹⁰. Në tremujorin e parë të 2015, të rinjtë e papunë ishin 34.1%.

Tregu i Punës në Shqipëri ka vazhduar të evoluojë dhe të përshtatet me kushtet e tregut në ndryshim, por jo aq shpejt apo në mënyrë fleksibël sa duhet. Tregu i punës akoma dominohet nga aktiviteti bujqësor privat i pakualifikuar dhe proporcioni i forcës punëtore në industri dhe në shërbime është shumë më poshtë se nivelet e vendeve të tjera në Europën Juglindore dhe Bashkimin Europian.

Në terma të pjesëmarrjes në forcën punëtore, shkalla e punësimit për popullsinë në moshë 15 - 64 vjeç, u ul nga 55.9% në 2012 drejt 52.1% në fillim të vitit 2015. Shkalla e përgjithshme e papunësisë në 2014 mbeti tek 17.9%, e rritur ndjeshëm në krahasim me 13.5% në 2007. Megjithatë, papunësia ishte në thelb më e lartë për të rinjtë 15 - 29 vjeç (nga 19.8% në 2007 drejt 32.5% në 2014). Në tremujorin e parë të vitit 2015, të rinjtë e papunë mbetën në nivel 34.1%.

Një tjetër aspekt kyç i tregut shqiptar të punës është proporcioni relativisht i lartë i inaktivitetit, që u rrit me 4.9% në 2013, dhe rezultoi në 1.6 herë më i lartë për gratë në krahasim me shifrën përkatëse për burrat, që ka tendencë të përforcojë stereotipin e femrave që konsiderohen si mbajtëset dhe kujdestaret e familjes.¹¹

Së fundi, tregu i punës në zonat rurale është një territor i panjohur që përballet me sfida të mëdha

⁴ Po aty.

⁵ Banka Botërore, Përlllogaritjet ECATSD duke përdorur të dhënat ECAPOV. Varfëria matet duke përdorur konsumin në nivelin e varfërisë tek \$2.50-në-ditë, rreth 2012. Pavarësisht ngadalësimit në ekonomi, pabarazia, e matur nga treguesi Gini, mbeti gjerësisht e pandryshuar. Treguesi Gini ishte 26.9 in 2012, krahasuar me 28.2 në 2008.

⁶ Banka Botërore, Po aty.

⁷ Flukset e Investimeve të Huaja Direkte janë reduktuar pothuajse përgjysmë në vitet e fundit, kryesisht për shkak të një rënie në investime nga investitorë tradicionalë të BE-së që kanë përjetuar stres ekonomik në vendet e veta.

⁸ NESS 2014-2020, par. 1.5.

⁹ INSTAT, *Tregu i Punës 2011-2012*.

¹⁰ INSTAT, *Studim i Forcës Punëtore*, 2015.

¹¹ Sipas përcaktimeve të INSTAT/Studimi i Forcës Punëtore: Popullsia aktive jo-ekonomike përfshin të gjithë personat që nuk klasifikohen si të punësuar ose të papunë (nxënës/studentë, punëtore shtëpiake, në një shërbim ushtarak të detyruar, pensionistë, invalidë, të papunë të dekurajuar). Shihni <http://www.INSTAT.gov.al/en/themes/labour-market.aspx>.

krahasuar me zonat urbane. Zonat rurale janë karakterizuar kryesisht nga forcë punëtore me aftësi të ulëta, mundësi të kufizuara, që mbështetet fort në mbijetesën bujqësore dhe ka nivele të larta varfërie¹².

2.3 Arsimi dhe formimi profesional (AFP)

Ata që kryejnë arsimin profesional janë në nivel dominues meshkuj, sidomos në vitet e fundit, që tregun se arsimi profesional është kapur kryesisht nga meshkujt. Arsytet për këtë fenomen me orientim të theksuar gjinor janë të ndryshme. Nga ana e ofertës, faktorët që dekurajojnë vajzat (dhe prindërit e tyre) që të zgjedhin arsimin profesional përfshijnë kurse dhe profile me stereotipe gjinore të rrënjësuar thellë, vendndodhja e shkollave AFP, mungesa e transportit, konviktet e pasigurta dhe klima e përgjithshme sociale në shkollat e AFP.¹³

Arsimi dhe Formimi Profesional ka potencial që të ndikojë në mënyrë pozitive integrimin në tregun e punës dhe gjenerimin e të ardhurave. Në periudhën 2009 - 2013, AFP ofrohej nëpërmjet një sistemi të centralizuar. Sistemi nuk ka qenë i aftë të përmbushë nevojat lokale kryesisht për shkak të ndarjes mes arsimit dhe formimit profesional dhe një qasje të papërshtatshme për monitorim dhe vlerësim¹⁴. Kjo ka rezultuar në një nivel të ulët (14.2%) pjesëmarrje në arsim dhe formim profesional gjatë kësaj periudhe. Formimi për të rriturit në Shqipëri është akoma në nivele foshnjore, me vetëm afro 1% të të rriturve të moshës 25 - 64 vjeç në programet e trajnimit dhe ritrajnimit profesional gjatë 2012 (krahasuar me 9% në vendet e BE-së). Në vitin aktual shkollor 2014/15, janë regjistruar rreth 6,000 nxënës në shkollat profesionale, një rritje e konsiderueshme prej 40% krahasuar me nivelet e 2013/14¹⁵.

Në sferën e AFP, ka bashkëpunim të kufizuar mes institucioneve që kryejnë formim profesional dhe bizneseve si punëdhënës potencialë. Kjo kufizon potencialin për të rritur punësimin pas përfundimit të arsimit dhe formimit profesional. Për të rinjtë, shkalla e interesit dhe atraktivitetit të AFP-së është e ulët, dhe ata e perceptojnë atë si opsionin e dytë më të mirë për të arritur tek arsimi i lartë, dhe jo si një rrugë për të hyrë në tregun e punës. Formimi për të rriturit është në faza foshnjërie, me vetëm një për qind të të rriturve (25-64 vjeç) në formimin profesional dhe programet e ritrajnimit në 2012 (krahasuar me 9% në BE). Si pasojë, aftësitë që merren nëpërmjet AFP-së nuk përputhen me nevojat në tregun e punës, duke rezultuar në mungesa për aftësi profesionale në disa sfera dhe superprodhim në aftësi në disa të tjera¹⁶.

Prandaj, sistemi shqiptar i AFP-së akoma ndikohet nga: (i) përfshirja e kufizuar e partnerëve socialë – në veçanti, marrëdhëniet mes sistemit të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe industrisë janë të dobëta; (ii) shumica e kurrikulave ofrojnë pak fushëpamje për eksperiencë pune të prekshme dhe nuk lidhen me standardet profesionale dhe ato të kualifikimit; (iii) aspektet e praktikës profesionale janë të kufizuara, përfshirë edhe në kurrikulat e AFP-së; (iv) një sistem i centralizuar në shkallë të lartë dhe me cilësi të ulët (më shumë se 60% e operatorëve publikë të AFP-së konsiderohen si performues të ulët ose të dobët me përgjegjshmëri të ulët ndaj nevojave lokale); (v) mungesë mësuesish të aftë dhe programe trajnimi për mësuesit (gjatë diplomimit dhe më pas në vazhdim të eksperiencës së punës); (vi) një hendek mes arsimit profesional dhe formimit profesional; (vii) qendrat e formimit profesional janë larg së qeni eficiente dhe që përmbushin misionin e tyre; (viii) të nën-financuara, me stimuj nxitës të varfër për pjesëmarrjen e punëdhënësve; dhe (ix) ambiente, kompetenca të stafit trajnues, kurrikula dhe infrastrukturë të kufizuar në Arsimin dhe Formimin Profesional.

2.4 Bujqësia

Bujqësia vazhdon të jetë në Shqipëri një nga sektorët më të rëndësishëm ekzistues dhe për zhvillimin potencial në të ardhmen. Sipas INSTAT-it, në 2013 ajo përbënte 18.3% të PBB, dhe mbetet sektori parësor për punësim, me afro 52% të të punësuarve me kohë të plotë. Gjatë periudhës 2007–2014 eksportet u rritën me 125.6% dhe importet me 44.6%. Në të njëjtën periudhë, prodhimi bujqësor u rrit me 25.5% dhe prodhimi agro-industrial u rrit me afro 32.1%. Në sferën e menaxhimit të tokës bujqësore, sipërfaqja e tokës nën prodhim u rrit me më shumë se 20,000 hektarë krahasuar me nivelet e vitit 2007. Aktualisht, afërsisht 2/3 e totalit të tokës bujqësore të disponueshme është në përdorim¹⁷.

¹² Studimi Kombëtar mbi Tregun Rural të Punës, UNDP Albania, Ref: UNDP/Duke trajtuar Përfshirjen Sociale nëpërmjet Arsimit dhe Formimit Profesional (*Addressing Social Inclusion through Vocational Education and Training*)

¹³ Analiza Gjinore e Programit të Zhvillimit të Burimeve Njerëzore dhe e sektorit të AFP-së në Shqipëri e GIZ, 2011.

¹⁴ Aftësitë 2020 Shqipëri (*Skills 2020 Albania*), European Training Foundation, Dokument pune, Tetor 2014

¹⁵ Po aty

¹⁶ Po aty

¹⁷ Ministria e Bujqësisë, *Strategjia e Integruar për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural 2014-2020*

Grafiku i mëposhtëm tregon të dhënat e disponueshme të regjistrimit të fundit të strukturës së ekonomisë shqiptare, duke marrë në konsideratë dy aspekte: i) përbërjen e PBB sipas sektorëve; ii) forcën punëtore sipas profesionit.

Tabela 1
Burimi: INSTAT, Regjistrimi 2011

	Bujqësi	Industri	Shërbime
Përbërja e PBB sipas sektorëve (2011 est.)	19.5%	12.0%	68.5%
Forca punëtore – sipas profesionit (2011 est.)	54.6%	12.8%	32.6%

Këto të dhëna tregojnë sa joproduktiv dhe i pazhvilluar është tregu i punës në Shqipëri dhe nevojën urgjente për të ndërhyrë në mënyrë eficiente në kualifikimin e forcës punëtore.

Për t’iu përgjigjur këtyre sfidave, në fund të vitit 2014 u aprovua “*Strategjia e Integruar për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural - SIBZHR 2014 - 2020*” nga Këshilli i Ministrave.

Mjeti kryesor për sfida afatgjata në sektorin e bujqësisë përfshijnë nevojën për t’iu adresuar niveleve të ulta të produktivitetit bujqësor dhe nivelit të pazhvilluar të rajoneve rurale.

Vizioni i SIBZHR synon “*Një sektor afro-ushqimor të qëndrueshëm, eficient, inovator, të aftë për të përballuar presionin e tregut të BE-së dhe zona rurale produktive që çojnë drejt aktiviteteve ekonomike dhe mundësive të punësimit, përfshirjes sociale dhe cilësisë së jetës për banorët e zonave rurale*”.

Prandaj një nga prioritetet më të larta të SIBZHR 2014-2020 është promovimi i cilësisë dhe prodhimit të qëndrueshëm ushqimor duke zhvilluar një sektor agro-ushqimor konkurrues dhe inovator që është i aftë të përballojë presionet e konkurrencës.

Nxjtja e të mësuarit gjatë gjithë jetës nëpërmjet trajnimit profesional dhe përfutimit të aftësive në zonat rurale është për më tepër në thelb të politikës kombëtare të Zhvillimit Rural siç tregohet në seksionin 3.1.4 të SIBZHR 2014 - 2020 “*Transferimi i njohurive dhe inovacionit në bujqësi, pyje dhe zona rurale dhe asistencë në zbatimin e politikave të zhvillimit rural*”.

Më qëllim që të trajtohen këto përparësi, Shqipëria ka nevojë të përmbushë standardet dhe kërkesat e tregut të BE-së deri në 2020 nëpërmjet si më poshtë:

1.1 Duke synuar si objektiv të paktën një rritje vjetore 8% në produktivitetin e punës bujqësore, për njësinë vjetore të punës (NJVP)/ të punësuarit me kohë të plotë, si dhe duke kualifikuar aftësitë e forcës punëtore;

1.2 Duke siguruar që të gjitha fermat dhe operatorët e regjistruar agro-përpunues janë në përputhje të plotë me standardet e BE-së (aplikimi i standardeve për 80% të të gjithë fermave dhe operatorëve të regjistruar agro-përpunues sipas normave të BE-së);

1.3 Rritja e madhësisë mesatare të fermave me të paktën 2.5 hektarë dhe rritje e mesatares së fermave komerciale me 3.5 hektarë;¹⁸

1.4 Përmirësim i organizimit të zinxhirit të vlerave nëpërmjet krijimit të 100 shoqatave dhe grupeve të prodhuesve dhe tipa të ngjashme bashkëpunimi mes fermerëve.

3. Politikat publike

3.1 Vizioni i qeverisë – Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim - SKZHI 2015 - 2020 (¹⁹) përcakton qartë vizionin kombëtar shqiptar:

“Shqipëria – një demokraci në forcim, në rrugën e integritit me Bashkimin European, me një ekonomi konkurruese, stabël dhe të qëndrueshme, dhe me garancitë për liritë dhe të drejtat themelore të njeriut”

Për të arritur këtë mision, SKZHI ka identifikuar mes të tjerash, prioritetet e mëposhtme:

Prioriteti 4: Sigurimi i rritjes nëpërmjet rritjes së konkurrueshmërisë dhe inovacionit

Prioriteti 5: Investimi tek Njerëzit dhe në Kohëzisionin Social

Këto prioritete do të trajtohen, ndër të tjerash, nëpërmjet:

- i) Kërkimit dhe inovacionit të tillë që të mund të përballojnë me sukses sfidat e të ardhmes;
- ii) Një shoqëri bazuar në dije dhe informacion;

¹⁸ Madhësia e një ferme përfshin edhe sipërfaqen e dhënë me qera për një periudhë afat-gjatë.

¹⁹ Drafti i fundit i disponueshëm i SKZHI 2015-2020, Gusht 2015

- iii) Një sistem arsimor modern që ka në qendër interesat dhe nevojat e nxënësve/studentëve;
- iv) Mundësi punësimi më të mëdha për të gjithë gratë dhe burrat në Shqipëri.

3.2 Politikat dhe strategjitë e AFP-së

Dokumenti shqiptar i politikave mbi AFP është Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA) 2014 - 2020, aprovuar në Tetor 2014 nga MMSR dhe Këshilli i Ministrave. Vizioni i SKPA 2014 - 2020 – frymëzuar nga qëllimi i përgjithshëm i Europa 2020 për të mundësuar rritje inteligjente, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse – është që deri në 2020, të arrihet një ekonomi konkurruese dhe një shoqëri gjithëpërfshirëse që bazohet mbi një truall me: ***“Aftësi në nivel më të lartë dhe vende pune më të mira për gjithë gratë dhe burrat”***.

Synimi i përgjithshëm i Strategjisë është të nxisë vende pune me cilësi dhe mundësi për aftësi profesionale për të gjithë gratë dhe burrat në Shqipëri gjatë gjithë ciklit të jetës. Kjo do të arrihet nëpërmjet veprimeve të politikave koherente dhe të harmonizuara që trajtojnë në mënyrë të vazhdueshme boshllëqet në kërkesën e punës, ofertën e punës dhe gjithëpërfshirjen sociale. Strategjia për Punësim dhe Aftësi mbështetet në katër prioritetet strategjike, si më poshtë:

- i) Të nxisë mundësi punësimi të denja nëpërmjet politikave efikase për tregun e punës;
- ii) Të ofrojë Arsim dhe Formim Profesional cilësor për të rinj dhe të rritur;
- iii) Të inkurajojë gjithëpërfshirjen sociale dhe kohezionin territorial;
- iv) Të forcojë qeverisjen e tregut të punës dhe sistemet e kualifikimit.

Objektivi kryesor i SKPA 2014 - 2020 është identifikimi dhe konceptimi i politikave të duhura për të nxitur punësimin përfshirë edhe formimin profesional të forcës punëtore me qëllim që të krijojë vende pune cilësore dhe mundësi për aftësi profesionale përgjatë gjithë ciklit të jetës së tyre.

Një nga prioritetet kryesore që has objektivi i sipërpërmendur është të sigurojë Arsim dhe Formim Profesional (AFP) cilësor për të rinj dhe të rritur nëpërmjet:

1.1 Rritjes prej 25% të numrit të pjesëmarrësve në programet e AFP-së dhe optimizmit të operatorëve të rrjetit të AFP-së;

1.2 Rritjes së cilësisë dhe efektivitetit të operatorëve të AFP-së nëpërmjet sigurimit të mbështetjes financiare dhe përshtatjes së inputeve dhe kapaciteteve të AFP-së (laboratorë, pajisje, kurrikulat, materiale mësimore, burime njerëzore);

1.3 Forcimi i lidhjeve mes studimit dhe punës, dhe koordinimi i kalimit drejt punës, duke përmbushur synimet e mëposhtme:

- i) Një rritje prej 40% në shkallën e punësimit të personave që përfundojnë arsimin profesional, 25% e të cilëve të jenë femra;
- ii) Një rritje prej 55% në nivelet e punësimit ndërmjet pjesëmarrësve në formimin profesional, prej të cilëve 75% duhet të jenë gra; dhe
- iii) Nxitje më e madhe e imazhit të AFP-së.

SKPA ka përgatitur truallin për përpunimin e projekt-ligjit të ri mbi AFP-në dhe Punësimin në Shqipëri. Projektligji është akoma në diskutime mes ekspertëve të MMSR-së dhe palëve të interesit kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Projektligji konfirmon rolin e MMSR-së në politikë-bërje dhe forcon kompetencat e Agjencisë Kombëtare për Kreditim dhe Kualifikime si dhe rolin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Ndër risitë e diskutuara, Ligji i ri ka shumë mundësi të prezantojë: i) autonominë financiare dhe organizative të shkollave të AFP-së; ii) mundësinë, për shkollat e AFP-së, të ofrojnë trajnim dhe arsim post-sekondar.

Një tjetër dokument kyç mbi punësimin dhe aftësitë profesionale është “Mbështetja për Sektorin e Punësimit dhe Aftësive në Shqipëri” Dokument i Veprimit të BE-së për Mbështetjen Buxhetore Sektoriale në kuadër të Instrumentit për Asistencë në Para-Aderim (IPA II) 2014-2020, mbi të cilën do të mbështetet Programi AFP për sa i përket objektivave dhe treguesve. Dokumenti i Veprimit që është përgatitur për mbështetjen buxhetore, përcakton rezultatet e pritshme që lidhen me progresin në pritje në lidhje me kriteret e përshtatshmërisë dhe performancën në zbatimin e strategjisë kombëtare apo sektoriale mbi AFP-në. Këto rezultate mund të përfshijnë konsolidimin e stabilizimit makroekonomik, nxitjen e reformave sektoriale dhe menaxhimin financiar publik, etj. Në këtë kontekst, Dokumenti i Veprimit ka identifikuar tashmë objektiva konkrete që do të lidhen me sistemin e monitorimit të performancës dhe do të mbulojnë progresin e pritshëm në zbatimin e politikave kombëtare relevante, strategji dhe procesit të reformës sektoriale.

Programi AFP i referohet **objektivit specifik 2 të Dokumentit të Veprimit:**

Të përmirësojë cilësinë dhe të rrisë mbulimin e Arsimit dhe Trajnimit Profesional.

3.3 Protokoll i Italo - Shqiptar i Bashkëpunimit për Zhvillim 2014 - 2016

Partneriteti mes Shqipërisë dhe Italisë bazohet në marrëdhëniet e veçanta historike, kulturore dhe ekonomike.

Organizata *Italian Development Cooperation* (IDC) (Bashkëpunimi Italian për Zhvillim) ka qenë i pranishëm në Shqipëri qysh prej vitit 1991, duke mbështetur zhvillimin social-ekonomik të vendit nëpërmjet programeve që synojnë të konsolidojnë sistemet prodhuese, të lidhin rrjetet rajonale të infrastrukturës, të nxisin menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve dhe të forcojnë kapacitetet institucionale si dhe shërbimet sociale, arsimore dhe shëndetësore.

Dialogu mes qeverive italiane dhe shqiptare është koherent dhe i konsoliduar, dhe ushqehet nga marrëdhëniet intensive të bashkëpunimit dypalësh në shumë sektorë dhe sfera. Bazuar në këtë, qeveritë italiane dhe shqiptare kanë rëndë dakord për një Protokoll të ri të Bashkëpunimit për Zhvillim që do të trajtojë tre shtylla të SKZHI dhe prioritete:

Rritje e Qëndrueshme nëpërmjet përmirësimit të konkurrueshmërisë dhe përdorimit eficient të burimeve, me vëmendje të veçantë në rritjen e *Konkurrueshmërisë dhe Inovacionit për rritje* në sektorët kyç të ekonomisë përfshirë në Bujqësi dhe Zhvillimin Rural;

Qeverisje e Mirë, Demokraci dhe Sundim i Ligjit. Duke njohur vlerën e parimeve europiane të subsidiaritetit dhe afërsisë së ofrimit të shërbimit të sektorit publik, IDC do të mbështesë reformën administrative territoriale të qeverisë shqiptare që është duke u realizuar me synimin për të fuqizuar Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQVs);

Investimi tek Njerëzit dhe në Kohëziorin Social do të fokusohet kryesisht në zhvillimin e burimeve njerëzore, veprimeve në funksion të përfshirjes sociale dhe kohezionit territorial, ndër të cilat është rënë dakord për një alokim prej 5 milion euro (kredi e butë) për të mbështetur ***Arsimin dhe Formimin Profesional nëpërmjet Inovacionit***. Në mënyrë specifike, Programi i financuar nga IDC do të fokusohet në mbështetjen e zgjerimit të një shoqërie të avancuar bazuar në dije, në përputhje me kërkesat e tregut të punës për të tërhequr IHD/IBD në sektorë produktivë ku, si Shqipëria ka një potencial të madh, edhe Italia ka një vlerë të shtuar të rëndësishme (d.m.th. përpunimin agro-ushqimor, agro-turizëm dhe turizëm, industri mode, mobiliari, etj.).

4. Analiza e problemit


4.1 Shqyrtim i sistemit të AFP-së në Shqipëri

Sistemi aktual arsimor në Shqipëri ofron 9 vite arsimit bazë të përgjithshëm dhe më pas arsimit mesëm zgjat deri në katër vjet dhe ndahet në (i) drejtimin e arsimit të përgjithshëm që përgatit nxënësit për arsimin e lartë, (ii) drejtimin profesional që përgatit nxënësit si për tregun e punës edhe për arsimin e lartë, dhe (iii) shkollat artistike, sportive, të gjuhëve të huaja dhe pedagogjike.²⁰

Figura e mëposhtme paraqet skematikisht sistemin arsimor shqiptar.

²⁰ Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, 2014, *Strategjia për Punësim dhe Aftësi 2014 – 2020*, p.9.

Figura 1:
Sistemi Arsikor në Shqipëri



Burimi : www.vet.al/oferts

AFP e nivelit arsimor të mesëm dhe post-sekondar vijon direkt pas arsimit bazë 9-vjeçar dhe ka si qëllim kryesor të bëjë të mundur që nxënësit të zhvillojnë aftësi profesionale dhe njohuri praktike. Ky tip arsimi prodhon teknikë dhe zanatçinj të specializuar me aftësitë e nevojshme për një profil pune specifik, por edhe i lejon nxënësit të vijnë në arsimin e lartë.

Shkollat profesionale janë të përqendruara në Shqipërinë qendrore (më shumë se 50%). Në zonat rurale, funksionojnë vetëm tre shkolla profesionale me fokusin kryesor në bujqësi dhe agro-biznes.

Arsimi profesional ofron programe AFP afatgjata (2, 3 dhe 4 vjet). Është prezantuar tashmë një strukturë e re arsimore që përbëhet nga tre nivele. Kjo strukturë është në përputhje me ISCO 2008 dhe ISCED 1997, me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) dhe me Kornizën Europiane të Kualifikimeve (EQF).

Aktualisht, janë regjistruar një total prej 29 150 nxënësish në të gjitha shkollat e operatorëve publik të AFP-së. Tre të katërtat janë nxënës në Shkollat e Mesme Profesionale (SHMP) dhe një e katërta janë në Qendrat e Formimit Profesional (QFP). Në SHMP-të, 25% e nxënësve marrin pjesë në sistemin me kohë të pjesshme. Të bie në sy dominimi i nxënësve meshkuj (82% në SHMP dhe 61% në QFP) krahasuar me nxënëset femra (18% në SHMP dhe 39% në QFP).

Numri i nxënësve me kohë të plotë në SHMP-të është rritur me 25% në tre vitet e fundit, ndërsa

numri i nxënësve me kohë të pjesshme në SHMP është rritur në mënyrë të jashtëzakonshme me 469% (afërsisht 5-fish) në tre vitet e fundit. Kjo tendencë është akoma më relevante në shkollat bujqësore të AFP-së²¹ dhe në mënyrë të qartë tregon se një numër i madh i individëve të punësuar, të vetëpunësuar apo të punësuar në të zezë në sektorin bujqësor ka nevojë të kualifikohet siç duhet me qëllim që të jetë nën nivelin e tregut të punës.

4.2 Boshllëqet strukturore të AFP-së

Sektori i AFP-së në Shqipëri, pavarësisht progresit të dukshëm në dy vitet e fundit, paraqet një sërë boshllëqesh strukturore që ka nevojë të merren në konsideratë²².

Në lidhje me cilësinë dhe përmbajtjen e programeve të AFP-së dhe kurseve afat-shkurtra, kurrikula e AFP-së nuk po prodhon të kualifikuar që të kenë njohuritë thelbësore, aftësitë dhe kompetencën profesionale për të hyrë në pozicione pune relevante me trajnimin në vendin e punës. Në shumicën e rasteve kjo është për shkak se neglizhohet trajnimi i aftësive praktike. Si rregull, klasat praktike kufizohen në demonstrime me pajisje të pakta dhe të dala nga përdorimi.

Një tjetër gjetje e rëndësishme është se arsimit profesional me kohë të pjesshme duket se është i pajisur varfërisht dhe nuk u jep ndonjë vlerë të shtuar pjesëmarrësve lidhur me aftësitë, për shkak se neglizhohet trajnimi i aftësive praktike. Mungesa e vlerësimit të të mësuarit të mëparshëm, përshtatjes së kurrikulave që të përqafohen edhe aftësi praktike dhe çështja e lëshimit të certifikatave të aftësisë kërkon vëmendje urgjente.

Në lidhje me *për zgjedhjen dhe pranimin e nxënësve/ të trajnuarve* ka mungesë të kriterëve bazë të pranimit të nxënësve para hyrjes në SHMP. SHMP-të zakonisht marrin nxënës me notë mesatare të ulët nga shkolla e arsimit bazë ose ata që nuk arrijnë të kalojnë në vitin e parë të gjimnazit.

Përbërja e nxënësve dhe të trajnuarve tregon se AFP aktuale është me orientim gjinor problematik dhe jo gjithë-përfshirëse. Regjistrimi aktual i grave/vajzave në AFP është i kufizuar. Proporcioni i meshkujve në SHMP është 82%, ndërsa përqindja e nxënësve femra në SHMP është vetëm 18%.

Lidhur me *personelin dhe zhvillimin e tij*, si cilësia dhe sasia e stafit administrativ dhe mësimor janë preokupime serioze për sistemin e AFP-së. Shumica e mësuesve japin në një profil AFP që korrespondon me arsimin e tyre (73% janë në përputhje dhe 11% në përputhje të pjesshme). Për instruktorët, shkalla e përputhshmërisë së lëndës që japin mësim dhe arsimit të tyre është më e ulët (60% janë në përputhje dhe 12% në përputhje të pjesshme). Në përgjithësi, kapaciteti i stafit administrativ dhe mësimor konsiderohet i pamjaftueshëm. Ka tregues të qartë se ka mungesë të instruktorëve/mësuesve të kualifikuar të AFP-së, që pengon përcjelljen praktikës dhe teorisë profesionale cilësore.

Për shkak të kushteve përgjithësisht të varfra të ambienteve dhe pajisjeve, nxënësit nuk janë në gjendje të familjarizohen me teknologjitë, veglat dhe instrumentet që përdoren në vendin e punës.

Organizimi dhe Menaxhimi është një çështje shumëplanëshe. Shumë studime demonstrojnë se të gjithë operatorët e AFP-së dhe sidomos SHMP-të vuajnë në menaxhimin e tyre të përditshëm të aktiviteteve për shkak të mungesës së autonomisë apo vetë-administrimit. Struktura administrative e sistemit të AFP-së është me kompleksitet të mbingarkuar; përgjegjësitë për 'jetën' e përditshme të SHMP-ve dhe QFP-ve shpërndahen mbi disa institucione qeveritare në nivel qendror dhe lokal. Niveli i decentralizimit është i ulët krahasuar me standardet evropiane.

Në lidhje me *gatishmërinë për punë dhe punësueshmërinë e të diplomuarve*, sistemi aktual i AFP-së nuk i pajis të diplomuarit (certifikuarit) e vet me aftësitë e nevojshme për të hyrë në tregun e punës. Një në tre nxënës që ndjek programe AFP për të cilat nuk ka aktivitete profesionale të përshtatshme (p.sh. ekonomi/ biznes, TIK, administrim zyre dhe ekonomi agrare) që të jetë i disponueshëm në tregun shqiptar të punës. Gjithashtu, mbitheksimi i AFP-së akademike drejtuar nga Matura, nuk rrit punësueshmërinë dhe gatishmërinë për punë të të diplomuarve nga AFP.

4.3 Boshllëqet e AFP-së në sektorët e bujqësisë dhe përpunimit agro-ushqimor

Studimi preferencial mbi AFP-në²³ demonstroi se sektori i përpunimit të mishit ka nevojë për supervizorë për procesin e prodhimit me aftësi menaxhimi dhe organizimi si dhe me njohuri mbi koston dhe proceset teknologjike. Industritë e vajit të ullirit dhe përpunimit të peshkut deklarojnë se

²¹ Studim preferencial - Studim që përcakton referencat, *sop. cit*

²² Gjetjet kryesore të studimit referencial, Po aty

²³ Po aty

teknologu ushqimor është kategoria më e vështirë për t'u përmbushur. Teknologjia e përdorur në bizneset aktuale nuk është e avancuar. Profesionit më i vështirë në prodhimin e ujit, pijeve të buta/freskuese që ka nevojë të plotësohet në tregun e punës është teknologu ushqimor. Personeli administrative dhe i menaxhimit të prodhimit të kompanisë zakonisht trajnohet nga ekspertë të huaj.

Kompanitë e bulmetit/djathit deklarojnë se nevojitet trajnim profesional për **supervizorë**, specialistë zbatimi (teknikë të lartë) për pasterizim, dhe mirëmbajtje dhe riparim makinerish. Fermat bujqësore dhe blegtorale përdorin pajisje dhe makineri të ndryshme. Duhet aftësi për të operuar makineritë dhe pajisjet si dhe për shërbimet e riparimit. Kompanitë e prodhimit të vezëve deklarojnë se pozicionet e stafit teknik (me diplomë të arsimit AFP të mesëm dhe/ose post-sekondar) janë vështirë të plotësohen për shkak të mungesës së ofertës së aftësive në këto profesione.

4.4 Boshllëqet e arsimit Post-sekondar

Programet e AFP post-sekondar për personat që përfundojnë gjimnazin janë ende në fazën e parë të zhvillimit dhe kryesisht ofrohen në kolegjet profesionale në universitetet publike me Universitetin e Durrësit që është në pararojë. Pavarësisht një strukture kursesh AFP të modernizuar kohët e fundit (2+1+1) që teorikisht dhe në parim do të lejonin fleksibilitetin e duhur vertikal dhe horizontal, me pika dalje dhe rihyrje, realiteti i zbatimit sikur po i zhvillon operatorët e arsimit profesional në operatorë të arsimit të përgjithshëm, me profile teknike dhe profesionale, por jo që t'i bëjë të aftë të diplomuarit të tregojnë punësueshmëri të plotë.

Një studim i kohëve të fundit i Fondacionit Europian të Trajnimit (*European Training Foundation*) ka identifikuar katër programe AFP post-sekondar që të zbatohen në një të ardhme të afërt :

- Përpunimi agro-ushqimor
- Prodhim dhe projektim tekstil & lëkurë
- Mekatronikë automobile
- Instruktor praktike profesionale

Megjithatë, parakushti kryesor për zbatimin e tyre të suksesshëm është që ato duhet të përfshijnë periudhat e praktikës në vendin e punës dhe eksperiencën në një kontekst relevant profesional. Kjo formë e mënyrës “jo-formale” të të mësuarit nuk është pjesë e të mësuarit në operatorët e AFP-së, por duhet të kryhet në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme industriale – me fjalë të tjera, në vendet e punës ku nxënësit do të punësohen më vonë.

Prandaj ekonomia shqiptare kërkon ofrimin e programeve AFP post-sekondare me qëllim që të reduktohet mungesa tepër e dukshme e specialistëve në nivel operacional (teknikë të lartë). Si rezultat, ndërmarrjet nuk janë në gjendje të plotësojnë vendet vakante me punëkërkues të trajnuar siç duhet. Kjo mungesë vepron si barrierë dhe frenon një rritje më të lartë ekonomike. Për momentin, sistemi i AFP-së nuk është në gjendje të kompensojë për këto mangësi si në terma të cilësisë edhe të sasisë.

4.5 Boshllëqet në aftësi në sektorin e AFP-së

Boshllëqet në aftësi në sektorin e AFP-së në Shqipëri zakonisht janë vënë në pah nëpërmjet “analizave periodike të nevojave për aftësi” përgatitur nga INSTAT, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, me asistencë teknike konstante nga donatorë ndërkombëtarë dhe në bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat²⁴.

Boshllëqet në aftësi ekzistojnë pothuajse në shumë kualifikime që kategorizohen si të vështira për t'u përmbushur në ofertat e tregut të punës. Për disa industri, ndër të cilat industritë e përpunimit agro-ushqimor, boshllëku në aftësi është problematik jo vetëm për funksionimin aktual të bizneseve, por në mënyrë të veçantë për të ardhmen që gjithnjë e më tepër do të imponojë nevojën për teknologji të avancuar dhe burime njerëzore me qëllim që të përputhen me standardet dhe rregulloret e BE-së.

Pothuajse të gjithë bizneset e kontaktuar²⁵ kanë opinionin se tregu i punës dominohet në nivel të lartë nga të rinjtë të cilëve u mungon dëshira për të punuar në “punë me duar të pista”. Atyre u mungojnë gjithashtu elementë të qëndrimit ndaj punës, praktikë dhe njohuri teknike. Kompanitë deklarojnë se praktika dhe njohuritë teknike mund të përmirësohen me kalimin e kohës nëpërmjet trajnimit, por kultura dhe dëshira për punë nuk janë aspekte që kompania do të donte të merrej.

Teknologët janë kualifikime që vështirë se plotësohen në pothuajse të gjitha industritë e përpunimit ushqimor dhe në biznese të tjera prodhuese. Teknologët aktualë janë afër moshës së pensionit dhe

²⁴ Aftësi 2020 Shqipëri (*Skills 2020 Albania*), European Training Foundation, Dokument Pune, Tetor 2014

²⁵ Po aty

kompanitë e shikojnë zëvendësimin e tyre shumë të vështirë. E njëjta gjë rezulton për kualifikimet për zooteknikë (mbarështues kafshësh) dhe veterinerë në industrinë e përpunimit ushqimor. Shumë kompani të mëdha kontraktajnë specialistë të huaj me kohë të pjesshme për këto kualifikime, pavarësisht të ardhurave të larta që marrin këta të fundit.²⁶

Për më tepër, kualifikimet xhenerik, elektro-auto dhe motoristë konsiderohen si kualifikime shumë të vështira për t'u plotësuar. Ka nevojë urgjente për teknikë në përdorimin dhe riparimin e makinerive bujqësore. Teknikët aktualë të përfshirë në bizneset e servisit të makinave janë afër moshës së pensionit.

Kurrikulat për kurset zhvillohen dhe aprovohen në dy nivele: (i) kurrikulat përgatiten nga ekspertë të kontraktuar në fushën përkatëse dhe aprovohen nga MMSR, dhe (ii) kurrikulat përgatiten nga ekspertët e QFP-ve dhe aprovohen nga Bordi Këshillimor. QFP-të përballen me disa probleme në lidhje me kurrikulat në të dy nivelet. Disa nga problemet janë: (i) shumë nga kurrikulat që po përdorin QFP-të janë më shumë se 10-vjeçare dhe vetëm në disa raste ka kurrikula të zhvilluara që nga 1995, dhe në këtë mënyrë niveli i dijeve teorike dhe praktike është i vjetër dhe nuk përputhet me nevojat si të bizneseve edhe të të trajnuarve; (ii) disa nga kurseve të reja ofruar në QFP-të, u mungojnë kornizat kurrikulare.

Në shumë raste, QFP-të individuale kanë zhvilluar kurrikulat nëpërmjet instruktorëve të tyre pa pasur paraprakisht kornizat kurrikulare sic parashihet në ligj. Në raste të tilla, me shumë gjasa veprohet me një qasje nga poshtë-lart për zhvillimin e kurrikulave, që do të thotë se MMSR do të zhvillonte kornizat kurrikulare bazuar në kurrikulat e QFP-ve. Kjo qasje është në kundërshtim me ligjin dhe gjithashtu nuk mund të garantojë cilësinë e kurrikulave dhe të të gjithave aspekteve që lidhen me të; (iii) ka mungesë fondesh për të mbështetur zhvillimin e kurrikulave dhe kuadri rregullator nuk është i plotësuar në këtë aspekt. Kështu, pothuajse të gjitha kurrikulat për QFP-të zhvillohen me mbështetjen e donatorëve të ndryshëm ose me punë vullnetare të QFP-ve. Ka raste në të cilat SKPA ka ndërmarrë iniciativën për të zhvilluar kurrikulat (si në rastin e kursit të turizmit), dhe ndonëse u bënë të gjitha rregullimet për ekspertët, mungonin si fondet edhe kuadri rregullator që do siguronte pagesën e tyre; (iv) aktualisht ka një rol tepër të dobët të AKAFPK-së në procesin e zhvillimit të kurrikulave.

Praktika tregon gjithashtu se kërkesa për kualifikime orientuar nga vendi i punës shkon përtej njohurive teknike, aftësive dhe kompetencës. Punëdhënësit kanë nevojë për një force punëtore të disponueshme që të furnizojë një kompleks aftësish thelbësore teknike, menaxheriale, iniciuese (apo aftësi gjenerike të tilla si aftësi përdorimi të kompjuterit, komunikim, aftësi analitike), dhe një varietet aftësish jo-konjitive si për shembull aftësi për punë në ekip, impenjim, dhe etikë pune. Gjithashtu, nevojitet që të shkohet përtej aftësive të punësueshmërisë.

4.6 Shkolla bujqësore AFP në rajonin e Fierit

Rajoni i Fierit vazhdon të jetë një nga zonat kryesore të prodhimit bujqësor në Shqipëri. Biznesi agrar po zhvillohet me shpejtësi i përqendruar në përpunimin e frutave (rrushit, ullinjve, lulediellit, etj.). 29 % e prodhimit të përgjithshëm bujqësor në Shqipëri realizohet në këtë rajon sipas analizës rajonale të nevojave për aftësi (SHKP 2013), që kërkon punësimin e specialistëve të zbatimit si teknologë ushqimorë dhe llogaritarë kostojë, sidomos në rajonin e sipërpërmendur. Më shumë se një e katërta e eksporteve bujqësore dhe agro-industriale bazohen në rajonin e Fierit.²⁷

Operatorët publikë të AFP-së janë të shpërndarë në mënyrë të pabarabartë në 12 (dymbëdhjetë) rajonet aktuale të vendit. Mund të ndahen në katër kategori numerike, bazuar në masën e popullsisë rezidente sipas rajoneve. Popullsia mesatare është 53 848 për çdo operator publik të AFP-së por është e shpërndarë në mënyrë shumë të ndryshme (për shembull, 26 918 banorë për operator të AFP-së në rajonin e Shkodrës me deri në 137 047 banorë për operator të AFP-së në rajonin e Dibrës). Rajoni i Fierit është ndër rajonet më të nënvlerësuara në Shqipëri bazuar në masën e popullsisë sipas rajonit, me popullsi rezidente 77.582 banorë për operator të AFP-së i vetëm, ky aspekt i ofertës rajonale së AFP-së tregon tashmë një nevojë urgjente për një ristrukturim rajonal dhe institucional të të gjithë sistemit të AFP-së.

Rajoni i Fierit duket i nënvlerësuar në nivel të konsiderueshëm me vetëm 6.6% të nxënësve/të trajnuarve krahasuar me proporcionin e popullsisë prej 11%. Fieri është një qytet industrial dhe rrethohet nga zona bujqësore kënetore. Duke marrë në konsideratë situatën, shkolla bujqësore AFP "*Rakip Kryeqiu*" është përzgjedhur që të zhvillohet në një qendër multi-funksionale, ndërsa shkolla AFP

²⁶ Po aty

²⁷ Po aty

në Lushnjë do të përfitojë ndërhyrje ekzakto që lidhen me mekanizimin bujqësor.

4.7 Vlerësimi i nevojave për shkollën “Rakip Kryeziu”

Shkolla AFP ka aktualisht 436 nxënës, nga të cilët 65 janë vajza, nxënësit rezidentë janë 138, dhe prej tyre 16 janë femra. Ka 28 mësues me kohë të plotë dhe 8 me kohë të pjesshme, ka gjithashtu 16 punonjës të administratës dhe të aktiviteteve fermere, pasi shkolla ka një parcelë prej 2,5 hektarë afër ambienteve të saj. Shkolla ka pasur fillimisht një total prej 10 hektarësh, por gjysma e tyre janë okupuar dhe kultivuar nga fermerë privatë që kanë ndërtuar edhe disa shtëpi. Pothuajse 3 hektarë janë të disponueshme dhe potencialisht mund të përdoren nga shkolla për aktivitete fermere shtesë.

Kurrikulat aktuale janë: Bujqësi, Teknologji Ushqimore dhe Shëndet Publik, me sistemin ekzistues: 2 vjet plus 1 plus 1. Kurrikula e veterinarisë, nga ana tjetër, ofrohet në bllok 4-vjet. Vlerësimi paraprak konceptoi zhvillimin e kurrikulave, duke marrë në konsideratë nevojat e tregut të punës, tiparet territoriale dhe nxitjen e vendeve të reja të punës për të rinjtë. Dy konviktet janë shumë të varfra, dhe po ashtu edhe mensa dhe ambientet e tjera. Stalla ekzistuese me gjedhë bulmeti nuk përmbush nevojat e të trajnuarve, dhe po ashtu edhe për makineritë bujqësore, fabrikën e përpunimit të qumështit dhe djathit, dhe pajisjet për të realizuar një përdorim eficient të tokës. Megjithatë, me një investim të duhur mundësuar nga Programi AFP, shkolla ka potencialin të bëhet një qendër multifunksionale.

4.8 Vlerësimi i nevojave të shkollës së Lushnjës

Shkolla e AFP-së ka aktualisht 570 nxënës, prej të cilëve vetëm 3 janë femra, nxënës rezident janë 20. Janë 40 mësues, dhe ka gjithashtu 9 instruktorë/teknikë dhe personel administrativ.

Kurrikulat përfshijnë pesë kurse: mekanikë transporti, hidraulikë, elektronikë, teknologji informacioni dhe mekanikë e përgjithshme. Kursi i fundit ka parë një ulje në regjistrimin e nxënësve.

Shkolla aktualisht përmbledh nxënës që vijnë nga një shkollë në Berat për trajnim praktik, që demonstroi kapacitetin e kësaj shkolle AFP për të nxitur koordinimin në rrjet dhe marrëdhënie me shkolla të tjera në rajon.

Magazina është e vogël dhe jo e pajisur mirë, ndërsa laboratorët praktikë janë mesatarë, ndërtesa dhe konvikti kanë nevojë për disa riparime, dhe po ashtu edhe ambientet e jashtme. Mësuesit dhe instruktorët janë të motivuar dhe të impenjuar dhe zhvillimi i mekanizimit bujqësor dhe hidraulika bujqësore përputhen në mënyrë perfekte brenda profileve ekzistuese. Në Tabelën n. 2 është aneksuar një opsion i propozuar për zhvillimin e kurrikulave.

5. Strategjia dhe metodologjia e Programit AFP

5.1 Strategjia e programit AFP

Strategjia e programit AFP bazohet në sistemin e mbështetur nga qeveria që mbledh shkollat e AFP-së dhe qendrat e formimit profesional nën autoritetin e MMSR-së²⁸ dhe synon të ndërtojë një sistem AFP të aftë të kontribuojë trajnim cilësor për forcën punëtore, me fokus special mbi të rinjtë, gratë dhe grupet në nevojë.

MMSR ka zhvilluar konceptin e qendrave multi-funksionale me qëllim që të trajtojë këto sfida. Amendimi i ligjit të AFP-së në 2011 krijoi një bazë ligjore për ndërtimin e Qendrave multifunksionale të AFP-së (QMF), që do të jenë porta hyrëse drejt tregut të punës, dhe një bërthamë e rëndësishme që do të lidhë klientët e AFP-së (të rinj, nxënës, të rritur) dhe punëdhënësit potencialë, nëpërmjet praktikave profesionale dhe punë praktike në ambientet e këtyre bizneseve lokale. Avantazhi krahasimor i qendrave multifunksionale të AFP-së *vis à vis* institucionet e Arsimit dhe Formimit Profesional, është që qendrat multifunksionale të AFP-së, nëpërmjet natyrës së tyre multifunksionale dhe gjithëpërfshirëse, operojnë si ‘një stacion me një ndalesë’, duke iu përgjigjur në mënyrë bashkëkohore nevojave të shumë përfituesve dhe nevojave të ndërthurura të komunitetit lokal dhe tregut të punës.²⁹

Kjo strategji bazohet në ristrukturimin rajonal të peizazhit të operatorëve të AFP-së bazuar në kriterin e orientuar nga cilësia të kompetencës dhe që çon drejt “Formimit të Qendrave të Ekselencës (ose Kompetencës) si pjesë e rrjeteve (sub)rajonale të AFP-së”. Synimi është që t’u japë një ose dy operatorëve rajonalë të fuqishëm mundësinë që të bëhen profesionalisht Qendra Multifunksionale AFP me një numër kampusesh satelite në rajonin në afërsi të tyre. Kjo qasje korrespondon me tendencat evropiane dhe italiane në Sektorin e AFP-së.

²⁸ Një Vendim i Këshillit të Ministrave në shtator 2013 transferoi kompetencat mbi shkollat e AFP-së nga Ministria e Arsimit dhe Sportit tek Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

²⁹ SKPA 2014-2020, Po aty

Forca shtytëse strategjike për ndryshim e Programit AFP do të jetë zbatimi i kurseve post-sekondare me cilësi të lartë në bujqësi dhe përpunimin agro-ushqimor.

Në fakt, programet profesionale post-sekondare janë paraparë nga qeveria shqiptare që të luajnë një rol thelbësor dhe të kontribuojnë në punësueshmëri, konkurrueshmëri ekonomike, rritje ekonomike të qëndrueshme dhe në nxitjen e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe të një ekonomie të bazuar në dije. Grupet e synuara që janë individualizuar nga SKPA 2014 - 2020 janë të diplomuarit nga shkollat e përgjithshme që dëshirojnë të marrin një program të fokusuar në punësim, që do të zëvendësojë arsimin paraprak profesional dhe të diplomuarit nga shkollat profesionale për të cilët vazhdimi i arsimit profesional është kryesisht çështje e përfitimit të së ardhurës nga investimi në të mësuarit.

Programet post-sekondare karakterizohen nga një fokus i fortë në tregun e punës. Ato janë përshtatur për nevojat e veçanta të ekonomisë lokale, rajonale dhe kombëtare. Kjo është ajo që dallon në mënyrë të veçantë programet profesionale post-sekondare nga programet që janë më tepër për diplomë akademike. Punëdhënësit potencialë do të shohin përfitimet e programeve post-sekondare kur të përfshihen në zhvillimin dhe zbatimin qysh nga fillimi i procesit. Sapo të ndërtohen, lidhjet e forta mes punëdhënësve dhe nxënësve mund të ndihmojnë dhe të kontribuojnë për një tranzicion të rrjedhshëm nga arsimi dhe trajnimi në tregun e punës.

Prezantimi i programeve post-sekondare të AFP-së filloi vetëm në 2007 dhe kështu është ende në fazë fillestare. Të gjitha programet post-sekondare AFP deri më tani, janë përgatitur dhe zbatuar brenda sektorit të arsimit të lartë.

5.2 Metodologjia

Strategjia e Programit AFP do të mbështetet mbi një metodologji novatore të të mësuarit në shkollën AFP. Kjo metodologji do të përfshijë konceptet e:

i) *Të mësuarit me bazë-problemi*³⁰: Të mësuarit me bazë problem do të merret thelbësisht në konsideratë për kurset e AFP-së të arsimit të mesëm.

ii) *Të mësuarit me bazë projekti*³¹: Të mësuarit me bazë projekti do të merret thelbësisht në konsideratë për kurset e AFP-së të arsimit post-sekondar.

iii) *Të mësuarit e ngjizur*³²: Të mësuarit e ngjizur do të merret thelbësisht në konsideratë për kurset e AFP-së afatshkurtër, sidomos ato që synojnë punonjës me nevoja për rikualifikim (për shembull trajnimi i operatorëve publikë të shërbimeve të zgjerimit).

iv) *Arsim jo-formal*³³: Të mësuarit jo-formal do të merret thelbësisht në konsideratë për kurset e AFP-së afatshkurtër, që synon në mënyrë të veçantë personat e papunë për një kohë të gjatë dhe grupe në nevojë si personat me aftësi të kufizuar, romët, egjiptianët, etj.

v) *Të mësuarit me vëzhgim*³⁴: Do të përdoret kryesisht për integrimin e nxënësve vulnerabil në komunitetin e shkollës.

Strategjia e Programit AFP do të bazohet gjithashtu në mekanizmin kyç që është provuar eficient për të siguruar një lidhje të vetë-qëndrueshme mes AFP-së dhe sektorit privat në kuadrin e sistemit dual efektiv: Pakti Territorial për Arsimin dhe Formimin Profesional (PTAFP) që është aplikuar në rajone të ndryshme të Italisë mund të jetë një shembull. PTAFP është një mekanizëm institucional që vë së bashku të gjithë palët e interesit relevante territoriale në një kuadër të vetëm ku fitojnë të gjithë palët. Situata ku fitojnë të gjithë palët gjenerohet nga një përshkrim i saktë i të drejtave dhe detyrave dhe një vështrim i qartë i shërbimeve të ofruara dhe të përfituara nga çdo palë interesi relevante. Tek Seksioni 6.3 “Rezultatet e pritshme” përfshihet një përshkrim më ezaures i PTAFP.

6. Konceptimi i programit

6.1 Objektivi i përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm i Programit është në përputhje të plotë me Dokumentin e Veprimit të IPA II mbi Sektorin e Punësimit dhe Aftësive:

Të kontribuojë për një treg pune më gjithëpërfshirës dhe më efektiv, duke mbështetur politika aktive

³⁰ *Të mësuarit me bazë problem (MBP)* është një pedagogji që ka në qendër nxënësin, ku nxënësi mëson për një lëndë nëpërmjet eksperiencës së zgjidhjes së një problemi të hapur. Nxënësit mësojnë si strategjitë e të menduarit dhe njohuritë për sferën përkatëse.

³¹ *Të mësuarit me bazë projekti* është një metodë të mësuarit ku nxënësit fitojnë njohuri dhe aftësi duke punuar për një periudhë kohe të zgjatur, për të investiguar dhe përgjigjur një pyetje, problemi apo sfida impenjuese dhe komplekse.

³² *Të mësuarit e ngjizur* është një program arsimor formal ku një nxënës mëson të paktën nëpërmjet përcjelljes së përmbajtjes dhe instruksionit nëpërmjet medias dixhitale dhe asaj online, me disa elementë të kontrollit të nxënësve në kohë, vend, lidhur me rrugën dhe ritmin.

³³ *Arsimi joformal*: çdo aktivitet arsimor i organizuar jashtë sistemit formal të ndërtuar – që ose operon veçan ose si një aspekt i rëndësishëm i një aktiviteti më të gjerë – që synohet t’u shërbejë klientelave për të mësuarit të identifikuar mirë dhe objektiveve të qartë të të mësuarit.

³⁴ *Të mësuarit me vëzhgim* është një praktikë të mësuarit ku nxënësit ndërveprojnë me nxënës të tjerë për të arritur synimet arsimore.

punësimi dhe zhvillimin e aftësive të forcës punëtore³⁵.

Tregues:

- i) shkalla e papunësisë së të rinjve. Burimi: INSTAT Shqipëria³⁶ - Studim për Forcën Punëtore (*Labour Force Survey* - LFS). Referenca 2013: 28.2 %;
- ii) Hendeku gjinor në punësim: INSTAT Shqipëria³⁷ - LFS. Referenca 2013: 13,8 %.

6.2 Objektivi specifik

Të ngrihet një shkollë e plotë multifunksionale AFP ekselence në sektorët e bujqësisë dhe përpunimit agro-ushqimor në shkollën “Rakip Kryeziu” në Fier dhe ndërhyrje specifike në Shkollën në Lushnjë në lidhje me mekanizimin bujqësor.

Tregues:

- i) Ndërtohet 1 shkollë multifunksionale AFP (Fier), përveç shkollave multifunksionale AFP mbështetur nëpërmjet SBS nga financimi i IPA II në sektorin AFP;
- ii) 1 shkollë AFP e kualifikuar sipas nevojave të tregut të punës së mekanikës bujqësore.
- iii) Rritet proporcioni i nxënësve femra dhe meshkuj që ndjekin Arsimin dhe Formimin Profesional në shkollat që ndodhen në zonat rurale. Referenca: për t'u përcaktuar³⁸;
- iv) Rritja e shkallës së punësimit të diplomuarve në arsimin profesional. Referenca LFS 2012: 15,7%³⁹

6.3 Rezultatet e pritshme

Rezultatet e pritshme të Programit AFP përfshihen në një qasje të plotë për të arritur sa më poshtë:

1. Qendra multifunksionale bujqësore e ekselencës e menaxhuar dhe organizuar në mënyrë eficiente dhe shkolla teknike e Lushnjës, e rikualifikuar sic duhet në sektorin e agro-mekanikës;
2. Zhvillohen kurrikula AFP dhe të orientuara nga tregu i punës;
3. Futet në kuadrin e sistem dual funksional lidhjet e qendrës multifunksionale me sektorin privat, sidomos në bujqësi dhe në sektorin e përpunimit agro-ushqimor;
4. Maksimizohet koherenca me financimin e IPA II për të Sektorin e Punësimit dhe Aftësive.

6.4 Komponentët e Programit AFP

Aktivitetet e detajuara për çdo rezultat të pritshëm të Programit AFP do të përfshijnë ndërhyrje fizike dhe jo-fizike që mund të përmbledhen në katër komponentët e mëposhtëm:

A. Rehabilitimi i infrastrukturës; ky komponent lidhet me zbatimin e punimeve ndërtimore; këto konsistojnë në rehabilitimin e ambienteve egzistuese për aktivitetet mësimore, punishtet, magazinat, për administratën dhe ambientet, ndërsa ndërtimet e reja do të shërbejnë për konvikte, laboratorë, magazine, fabrika përpunimi dhe pjesë shërbimesh; mund të përmirësohen gjithashtu edhe ambientet e jashtme;

B. Blerje mallrash (Pajisje & Laboratore): pajisje teknike dhe didaktike, makineri dhe njësi bujqësore, mobilie, pajisje zyre, libra dhe të gjitha mallrat e parashikuar për tenderim nën Programin AFP;

C. Asistencë institucionale teknike; për të siguruar funksionimin e duhur të shkollave AFP që janë objekt i Programit, si dhe do të sigurohet për shkollat e AFP-së një asistencë teknike institucionale e shkëlqyer, në terma binjakëzimi, bazuar në eksperiencat më të mira të BE-së në sektorin e AFP-së, sidomos në ato që janë më afër me kontekstin shqiptar; termat e referencës detajohen në dokument;

D. Asistencë për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për të orientuar dhe monitoruar zhvillimin e politikave, zbatimin e strategjisë dhe vlerësimin e saj, prokurimet, komunikimin si në forcimin e koordinimit të donatorëve dhe sektorit nëpërmjet Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) dhe Sekretariatit të tij Teknik, sidomos në procesin e procedurave të prokurimit.

6.5 Aktivitetet

Rezultati 1: Qendra multifunksionale bujqësore e ekselencës e menaxhuar dhe organizuar në mënyrë eficiente dhe shkolla teknike e Lushnjës, e rikualifikuar siç duhet në sektorin e agro-mekanikës.

1.1 Zhvillimi i infrastrukturës së shkollës

Niveli dhe detajet e zhvillimit të infrastrukturës do të përpunohen në përputhje me nevojat specifike

³⁵ Në linjë me objektivin e përgjithshëm të mbështetjes sektoriale IPA II për Strategjinë për Punësim dhe Aftësi në periudhën 2015-18, në përputhje me Dokumentin Strategjik 2014-2020 për Shqipërinë. shihni: Draft i Dokumentit të Veprimit “Mbështetje për Sektorin e Punësimit dhe Aftësive”, Delegacioni i Bashkimit Europian në Shqipëri.

³⁶ Si % e 15-29 vjeç të papunë- Tregues për Strategjinë për Punësim dhe Aftësi

³⁷ Diferenca që bëhet mes shkallës së punësimit mes femrave dhe meshkujve- Tregues për Strategjinë për Punësim dhe Aftësi

³⁸ Draft i Dokumentit të Veprimit “Mbështetje për Sektorin e Punësimit dhe Aftësive”, Delegacioni i Bashkimit Europian në Shqipëri

³⁹ Po aty

të shkollës AFP dhe duke marrë në konsideratë ndërhyrje të tjera të parashikuara me qëllim që të zhvillohen sinergji dhe të shmangen mbivendosjet.

Qëllimi i rehabilitimit/ndërtimit të ndërtesave ekzistuese/të reja dhe zonave të hapura është të krijohet mjedisi i përshtatshëm për qendra rezidenciale multifunkionale në sistemin AFP. Kriteret e konceptimit dhe standardet e ndërtimit do të jenë konform një destinacioni të tillë; në përputhje me kodet e ndërtimit, standardet dhe rregullore shqiptare do të jenë një domosdoshmëri; në disa raste do të aplikohet një cilësi më e lartë dhe standardet e sigurisë, në përputhje me standardet dhe kërkesat e BE-së.

1.2 Ferma demonstrimi, stalla, fabrikë përpunimi agro-ushqimor dhe pajisje laboratorike

Aktiviteti praktik në Arsimin dhe Formimin Profesional bujqësor është jetik për zhvillimi e aftësive të nxënësve dhe do të adresojë me vëmendje të veçantë pjesën praktike të çdo kurrikule përcaktuar në rezultatin e pritshëm të dytë. Stalla të mirëpajisura, serra, laborator dhe fabrikë përpunimi agro-ushqimor janë gjithashtu shtylla kryesore për krijimin e marrëdhënieve stabël me sektorin privat deri në një shkallë sa të jetë e mundur, që të ofrohen edhe disa shërbime për bizneset dhe në këmbim të merren materiale/pajisje demonstrimi për të testuar/pilotuar në nivel nxënësish dhe mësuesish. Agro-përpunimi dhe laboratorët do të strukturoren në përputhje me nevojat si të nivelit AFP sekondar edhe post-sekondar. Do të përgatitet një listë e detajuar nga asistenca teknike gjatë fazës së zbatimit.

2. Bordi drejtues i shkollës

Sipas legjislacionit aktual shqiptar të AFP-së, çdo institucion AFP do të ketë një bord drejtues të përbërë nga përfaqësues të shkollës, sektorit privat, nga komuniteti i nxënësve dhe mësuesve. Programi AFP do të asistojë shkollën në ringritjen e Bordit dhe bërjen e tij funksional, dhe në të njëjtën kohë do të asistojë MMSR që të përpunojë dhe të zbatojë në mënyrë efikase aktet nënligjore të nevojshme që lidhen me të. Më specifikisht, përfaqësuesit e komunitetit të biznesit në bujqësi dhe në sektorin e përpunimit agro-ushqimor, do të ftohen të marrin pjesë plotësisht në Bord dhe të kontribuojnë në zhvillimin e kurrilave dhe në përmirësimin e qendrave multifunkionale AFP të ekselencës.

3. Menaxhimi i burimeve njerëzore (të brendshme dhe të jashtme)

Programi AFP do të zhvillojë një plan të përgjithshëm për menaxhimin e burimeve njerëzore bazuar në një vlerësim të saktë të nevojave për trajnim të personelit të shkollës, si teknik edhe administrativ. Do të organizohen programe trajnimi të përshtatur me qëllim që të bëhet shkolla më tërheqëse për të ardhurit. Do të tregohet vëmendje e veçantë për kontributin e jashtëm të mësuesve dhe ekspertëve nga komuniteti i biznesit me qëllim që të sigurohet një lidhje më efektive me tregun e punës dhe teknologjitë e reja.

4. Program trajnimi i përgjithshëm

Ky aktivitet është pjesa më relevante e rezultatit të parë të pritshëm. Plan i Trajnimit të Përgjithshëm i shkollës AFP do të përbëjë bazën për një menaxhim shkolle operativ me kosto efektiv dhe do të përfshijë (por jo vetëm) elementët e mëposhtëm: a) rregulloren e brendshme të shkollës; b) grafikun e organizimit të shkollës; c) class kriteret e formimit të klasës; d) kriteret e pranimi, vlerësimit dhe vlerësimit të dijeve; e) trajnimin e përgjithshëm dhe objektivat specifike, objektivat e përgjithshme dhe specifike të arsimimit f) një listë të plotë dhe të detajuar të kurrikulave shkollore, duke përfshirë vizitat, praktikën profesionale, faza dhe programe për punësimin aktiv; g) shërbime për mbështetje familjare; h) aktivitete pas shkollës dhe që nuk lidhen me shkollën; i) shërbime të asistencës psikologjike; j) përpunimin e projekteve specifike shkollore dhe ekstrakurrikulare për grupe të ndryshme me nxënës nga shtresat në nevojë.

4.1 Shërbim karriere

Do të ngrihet një Shërbim Karriere brenda shkollës. Nxënës, nga arsimi sekondar dhe post-sekondar do të monitorohen në mënyrë konstante në rrugën e tyre kur të hyjnë në tregun e punës. Do të ofrohen një seri shërbimesh orientimi dhe mentorimi. Shkolla do të përpunojë edhe një bazë të dhënash dhe një sistem monitorimi për ndjekjen më tej të nxënësve. Të gjitha ndërmarrjet private të angazhuara në bordin e shkollës do të marrin pjesë proaktive në përshtatjen e specializuar të Shërbimit të Karrierës

4.2 Sigurimi i Cilësisë

Ky aktivitet do të sigurojë standardet për një sistem solid të sigurimit të cilësisë për qendrën multifunkionale të ekselencës në të tre nivelet e ofertës së AFP-së: kurset e arsimit të mesëm, arsimit post-sekondar dhe kurset afat-shkurtër. Sigurimi i cilësisë do të adresojë përfituesit e mëposhtëm: i) nivelin sa të kënaqur janë nxënësit; ii) vetë-vlerësim të personelit mësues; iii) vlerësim të personelit

administrativ. Standartet do të jenë në përputhje me dispozitat e MMSR-së.

4.3 Akreditimi dhe Certifikimi

Ky aktivitet do të përgatisë truallin për: i) lëshimin e certifikatave dhe diplomave AFP të vlefshme dhe të njohura gjerësisht bazuar në sistemin e kualifikimeve të MMSR-së; ii) progresin e akreditimit të shkollës drejt Sistemit European të Sigurimit të Cilësisë. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet trajnimit të menaxherëve të shkollave në përgatitjen e propozimeve të mira projektsh (sipas metodologjisë së Ciklit të Projektit) nën Programin Erasmus + dhe Fondet Strukturale që pritet të fillojnë (sidomos Fondi Social European).

Rezultati 2: Një sistem eficient dhe i orientuar nga tregu i punës dhe kurrikula AFP të përgatitura dhe në funksionim.

Siç u përcaktua edhe në paragrafët e mëposhtëm, Programi do të ndërhyjë në secilin prej tre nivelet e ofertës AFP në Shkollën e Ekselencës me qëllim që të jetë në gjendje të adresojë të gjitha boshllëqet e identifikuara në lidhje me aftësitë në sektorin e bujqësisë dhe atë të përpunimit agro-ushqimor. Përzgjedhja dhe përgatitja e kryhen në bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat që ka një perspektivë më të gjerë për orientimin e tregut.

2.1 Kurrikulat AFP të nivelit të arsimit të mesëm

Kurrikulat AFP të nivelit të arsimit të mesëm do të përfitojnë nga pikat e forta dhe aspektet specifike të rajonit të Fierit dhe do të jenë në gjendje të prodhojnë teknikë të mesëm dhe të lartë në Sekondar: i) prodhimin dhe parketimin e perimeve dhe frutave; ii) transformimin e produkteve bujqësore (agro-përpunimin dhe agro-industrinë); iii) mekanizimin bujqësor iv) shërbime veterinare, përfshi edhe sigurinë ushqimore.

2.2 Kurrikulat AFP për kurse afat-shkurtra

Oferta afat-shkurtër si instrument i të mësuarit gjatë gjithë jetës, do të drejtohet, por jo ekskluzivisht, në: i) njerëz që janë tashmë në tregun e punës që kanë nevojë për kualifikime ose rikualifikime; ii) zyrtarë publikë që mbulojnë realizimin e shërbimeve të zgjerimit në bujqësi dhe në zonat rurale; iii) studentë të nivelit të arsimit të lartë.

Disa nga kurset e propozuara mund të përfshijnë temat e mëposhtme: i) bashkëpunimi në bujqësi; ii) sistemet GIS në bujqësi; iii) ARRPKK; iv) ndërtimi dhe menaxhimi i serrave; iv) zbukurimet e gjelbra urbane (parimet agro-mjedisore); v) teknikat e fidanishtes; vi) trajtimet dhe kontrolli fito-sanitar etj; vii) menaxhimi i integruar i dëmtuesve (MID) dhe prodhimi organik.

2.3 Kurrikulat AFP post-sekondare

Siç u përcaktua edhe në strategjinë e programit, arsimi post-sekondar do të jetë forca shtytëse në qendrat bujqësore multifunkionale të ekselencës. Këto kurse të arsimit të lartë do të prodhojnë profile profesionale të specializimit të lartë, që të jenë në gjendje të jenë në pararojë të zhvillimit në sektorët e bujqësisë dhe të përpunimit agro-ushqimor, që në fazën e pilotimit mund të përfshijnë: i) menaxher ferme, fermë organike, ndërmarrje agro-ushqimore; ii) teknolog i specializuar agro-ushqimor; iii) ekspert mbi sigurinë ushqimore gjurmueshmërinë, iv) analiza dëmi.

2.4 Trajnim trajnerësh

Do të realizohet trajnim trajnerësh bazuar në kurrikulat AFP përmendur më sipër.

Rezultati 3: Ngrihen marrëdhënie eficiente, të përshtatura specifikisht dhe të qëndrueshme, të qendrës multifunkionale AFP të ekselencës me sektorin privat, sidomos në sektorët e bujqësisë dhe të përpunimit agro-ushqimor

3.1 Shërbime të shkollës AFP për palë të treta

Ky aktivitet do të jetë shumë novator përderisa do të pilotojë ndërtimin e një 'ndërmarrje bujqësore' të menaxhuar nga vetë shkolla AFP, me qëllim që të sigurojë në terma afat-mesëm vetë-qëndrueshmëri financiare të shkollës së AFP-së. MMSR do të garantojë përpunimin dhe zbatimin e akteve relevante nënligjore me qëllim që të testohet aktiviteti pilot.

'Ndërmarrja bujqësore' do të ofrojë disa shërbime dhe do të shesë produkte (prodhuar gjatë fazës praktike të kurrikulave) tek palë të treta. Ndërmarrja bujqësore do të ketë të gjitha karakteristikat bazë të një ndërmarrje sociale jo-fitimprurëse, bazuar në modelin dhe praktikën më të mira italiane në këtë sektor. Do të bëhet dhe arrihet dakordësi për një plan menaxhimi të detajuar mes MMSR dhe vetë shkollës.

3.2 Pilotimi i ndërtimit të një Pakti Territorial për AFP dhe Punësimin (PTAFP)

Ky aktivitet do të përballet specifikisht me sfidën institucionale të ndërtimit të një PTAFP të plotë,

të gjithanshëm në rajonin e Fierit. PTAFP do të përfitojë nga eksperiencat më të mira italiane në këtë aspekt. Ai do të përfshijë MMSR-në (dhe zyrat e saj të dekoncentruara në nivel territorial), shoqata relevante biznesi dhe të sektorit, ndërmarrje private italiane dhe shqiptare, autoritete lokale dhe zyra rajonale të MMSR-së dhe të Ministrive të linjës relevante. Misioni i tij thelbësor do të jetë të ngrejë dhe të ushqejë një ambient ku të gjitha palët fitojnë mes tregut të punës, MMSR-së (dhe të Ministrive të linjës relevante dhe Partnerëve për Zhvillim dhe Integrim) dhe shkollës AFP.

Në nivel optimal, qendra multifunksionale AFP e ekselencës në Fier (si dhe ajo e shkollës mekanike në Lushnje) mund t'i ofrojë sektorit privat: i) ambiente laboratorit për analiza dhe certifikime; ii) riparime dhe shërbime për automjetet bujqësore; iii) produkte cilësore bujqësore (fruta dhe perime); iv) materiale për fidanishte; v) punë me kohë të pjesshme për nxënës në nevojë dhe ata rezidentë; vi) bursa.

Nga ana tjetër, sektori privat mund t'i ofrojë shkollës AFP: i) skema të praktikës profesionale për ofertën e AFP të arsimit të mesëm; ii) gjetje pune për nxënës të arsimit AFP të mesëm dhe më e rëndësishmja, për ata të arsimit AFP post-sekondar (në sinergji me skemat e Shërbimit Kombëtar të Punësimit⁴⁰; iii) trajnerë të specializuar që vijnë nga brenda sektorit të biznesit; iv) bursa speciale dhe mundësi për gjetje pune për nxënës në nevojë.

Autoritetet relevante shqiptare mund t'i ofrojnë shkollës AFP: i) grante dhe skema mikrokredie për të rinjtë sipërmarrës bujqësorë (që vijnë kryesisht nga profile post-sekondare); ii) skema të Shërbimit Kombëtar të Punësimit; iii) akreditim për realizimin e moduleve të trajnimit për shërbime zgjerimi; iv) bursa; v) praktika profesionale të posaçme me bursë, praktikë profesionale dhe mundësi gjetje pune për nxënës në nevojë.

Ndërmarrjet italiane dhe asistenca teknike AFP mund t'i ofrojë shkollës AFP: i) trajnime ndërkombëtare; ii) gjetje pune; iii) binjakëzim me shkolla të tjera AFP; iv) shkëmbim të praktikave të mira në lidhje me përfshirje për punë të nxënësve në nevojë.

Rezultati 4: Sigurohet koherencë me financimin IPA II për Sektorin e Punësimit dhe Aftësive

Me qëllim që të sigurohet koherencë me Mbështetjen Buxhetore të IPA II për Sektorin e Punësimit dhe Aftësive, në lidhje me komponentin AFP, Programi do të mbështetet në të njëjtët tregues si tek Dokumenti i Veprimit i BE-së mbi Sektorin social, të Punësimit dhe Aftësive lidhur me objektivat e përgjithshme dhe specifike. Në mënyrë specifike, qendra multifunksionale AFP në Fier do t'u shtohet atyre që mbështeten nga BE nëpërmjet SBS⁴¹ (në terma praktikë, nëse SBS e BE-së do të kontribuojë për n shkolla AFP, qendra bujqësore multifunksionale AFP në Fier përbën $n+1$).

Me ngritjen e mekanizmit GMIP, i cili është një grup vendim-marrës i nivelit të lartë, kryesuar nga Ministri i Institucionit drejtues, me përgjegjësinë e gjithanshme për sektorin, MMSR është Ministria për GMIP mbi Punësimin, Aftësitë dhe Përfshirjen Sociale. Siç tregohet edhe në udhëzimet operative të GMIP, Ministria drejtuese përfiton nga mbështetja teknike menaxheriale dhe administrative nga një sekretariat i dedikuar GMIP dhe grupet me tematikë relevante me bazë në Ministrinë drejtuese.

Në këtë kontekst, Programi AFP do të asistojë MMSR-në në aktivitetet specifike që synojnë forcimin e Sekretariatit dhe grupeve tematike relevante në funksionet e tyre respektive.

4.1 Menaxhim i Programit

Për të siguruar menaxhimin e projektit në nivel dhe kohë të duhur, Programi AFP parasheh përzgjedhjen dhe caktimin e një Menaxheri Projekti që do të veprojë si personi fokal në MMSR për zbatimin e Programit AFP. Ai/ajo do të garantojë ndërkomunikimin e duhur mes MMSR-së dhe Agjencive të saj Kombëtare, shkollave në Fier dhe Lushnje, dhe asistencës institucionale të binjakëzuar. Menaxhimi i Programit përfshin edhe sigurimin e ambienteve dhe mbështetjes me personel.

4.2 Shërbime teknike

Ky aktivitet do të sigurojë mbështetjen e duhur institucionale teknike për Sekretariatin dhe Grupet Tematike të GMIP për gjithë planifikimin e përgjithshëm të sektorit, programimin dhe buxhetimin drejt një zbatimi efektiv dhe në kohën e duhur të SKPA 2014-2020. Ky aktivitet do të sigurohet nga Këshilltari Rezident i Binjakëzimit⁴².

⁴⁰ Skemat e Shërbimit Kombëtar të Punësimit mbështesin vende të reja pune që gjenerohen nga sektori privat, duke bashkë-financuar për një periudhë kohe të caktuar, kostot e kontributeve sociale dhe shëndetësore, si për punonjësit edhe për punëdhënësit

⁴¹ SBS – Sector Budget Support (Mbështetje Buxhetore Sektoriale) – shënim i përkthyesit

⁴² Shihni Termat relevante të Referencës përfshirë në Fishën e Kontratës Standarte të Binjakëzimit bashkëlidhur, për një shqyrtim të plotë të funksioneve të Këshilltarit Rezident të Binjakëzimit.

4.3 Shërbime prokurimi

Ky aktivitet do të realizojë asistencë të specializuar administrative e teknike për të siguruar që aktivitetet e prokurimit të Programit kryhen në kohë dhe në mënyrë eficiente sipas rregullave të prokurimit rënë dakord specifikisht në nivel dypalësh, dhe në përputhje me rregullat dhe rregulloret e aplikueshme të BE-së.

4.4 Komunikimi dhe vizibiliteti

Ky aktivitet do të mbështesë zhvillimin e një strategjie komunikimi të duhur për të informuar, përditësuar dhe shkëmbyer informacion mbi zbatimin dhe arritjet e Programit.

7. Përfituesit

- Përfituesit e drejtpërdrejtë të Programit janë;
- Shkolla AFP *"Rakip Kryeziu"* në Fier
- Shkolla AFP në Lushnje
- Nxënës dhe mësues të Shkollës AFP *"Rakip Kryeziu"* në Fier, sidomos vajzat e reja
- Nxënës dhe mësues të Shkollës AFP në Lushnje, sidomos vajzat e reja
- Komunitete fermerësh
- Familje të nxënësve të AFP
- Nxënës me aftësi të kufizuar dhe/ose që u përkasin komuniteteve Rome/Egjiptiane
- Përfitues indirektë janë:
- Ndërmarrjet Bujqësore dhe Agro-ushqimore dhe Shoqatat e Biznesit
- Në plan të përgjithshëm, popullsia rurale shqiptare

8. Plani i Punës dhe Buxheti

Plani i punës është zhvilluar në përputhje me aktivitetet e parashikuar për rezultatet e pritshme për periudhën 3-vjeçare të programit.

Grafiku n. 1

		Përshkrimi	Viti 1		Viti 2		Viti 3	
Aktiviteti	Nën aktiviteti	Rezultati 1	I Sem	II Sem	I Sem	II Sem	I Sem	II Sem
0	0.0	Startimi i Programit AFP dhe një Plan Pune i përditësuar, që të aprovohet nga Komiteti Drejtues						
1.1	1.1.1	Tenderim për Kontratën e Binjakëzimit						
	1.1.2	Përgatitja e Konceptimit të Projektit për punimet e ndërtimit/rindërtimit për të dy shkollat						
	1.1.3	Tenderim për Kontratën/Kontratat e punimeve						
	1.1.4	Punimet, mbikëqyrja dhe kontrata e binjakëzimit e nënshkruar						
	1.1.5	Punime Ndërtimi						
	1.1.6	Mbikëqyrje punimesh						
	1.1.7	Testimi final						
1.2	1.2.1	Tenderim për Kontratën/Kontratat për pajisjet						
	1.2.2	Kontratë/Kontrata furnizimi për blerjen e laboratorëve dhe pajisjeve, e nënshkruar dhe e zbatuar						
	1.2.3	Kontrata furnizimi për blerjen e makinerive, automjeteve bujqësore, e nënshkruar dhe e zbatuar						
	1.2.4	Kontrata furnizimi për blerjen, e nënshkruar dhe e zbatuar						
	1.2.5	Kontrata furnizimi dhe blerjen e materialeve didaktike						
1.3		Bordi Drejtues i Shkollës						
1.4		Menaxhimi i Burimeve Njerëzore						
1.5		Program i Përgjithshëm Trajnimi						
1.6		Shërbim Karriere						
1.7		Standardet për Sigurimin e Cilësisë						
1.8		Akreditimi dhe certifikimi						
		Rezultati 2						
2.1		Tenderim për Kontratën e Binjakëzimit						
2.1		Nënshkruhet Kontrata e Binjakëzimit						
2.1		Zhvillimi dhe përcjellja e kurrikulave të nivelit të mesëm						
2.2		Zhvillimi dhe përcjellja e kurrikulave afatshkurtra						

2.3		Zhvillimi dhe përcjellja e kurrikulave të nivelit post-sekondar							
2.4		Trajnimi i trajnerëve							
		Rezultati 3							
		Tenderim për kontratën e binjakëzimit							
		Nënshkruhet kontrata e binjakëzimit							
3.1		Shërbime shkollare për palë të treta							
3.2		Pilotimi i PTAFP							
		Rezultati 4							
2.1		Tenderim për Kontratën e Binjakëzimit							
2.1		Nënshkruhet Kontrata e Binjakëzimit							
4.1		Rekrutimi i Personelit që i caktohet MMSR							
4.1		Menaxhimi i Programit							
4.2		Mbështetje teknike institucionale							
4.3		Prokurim							
4.4		Aktivitetet dhe strategjia e komunikimit							

Buxheti i alokuar arrin në një total prej 5 Milion Euro për një periudhë prej tre vitesh që ana italiane do të ofrojë kredinë e butë. Tabela e mëposhtme vë në dukje përllogaritjen e përgjithshme të kostove sipas komponentëve për të lehtësuar planifikimin e prokurimeve, monitorimin dhe mbikëqyrjen. Është i aneksuar edhe një buxhet paraprak më në detaje (Aneksi n. 2).

Tabela n. 2- Përllogaritja e përgjithshme e kostove në Euro sipas komponentëve dhe shkollave përfituese

	Fier (në Euro)	Lushnje (në Euro)	Total (në Euro)
Komponenti A Rehabilitimi dhe ndërtimi i infrastrukturës	1.090.200	172.800	1.263.000
Komponenti B Laboratorë & pajisje	1.980.000	260.000	2.240.000
Komponenti C Asistencë teknike profesionale			1.335.000
Komponenti D Asistencë për MMSR			162.000
Totali i plotë			5.000.000

9. Komunikimi dhe vizibiliteti

MMSR dhe IDC do të komunikojnë dhe të ngrenë ndërgjegshmërinë mbi progresin e Programit AFP me partnerët lokalë, kombëtarë, rajonalë dhe ndërkombëtarë si dhe me palët e interesit. Për vizibilitetin do të tregohet vëmendje nëpërmjet seminareve, takimeve, vizitave në shkolla, fushata publike, etj. Do të bëhen prezantime mbi zbatimin dhe arritjet në evenimente kombëtare dhe rajonale dhe në forume kur të jetë e përshtatshme.

Sekretariati Teknik i GMIP do të koordinojë rrjedhat e komunikimit mes anëtarëve dhe strukturave të GMIP për të siguruar një gamë informacioni sa më të gjerë rreth Programit AFP.

10. Kuadri institucional dhe marrëveshja për zbatimin

10.1 Përgjegjësitë dhe modalitetet e zbatimit

Para fillimit të fazës së zbatimit, do të nënshkruhet një Marrëveshje Dypalëshe mes Qeverive Shqiptare dhe Italiane për Programin (MDP) që do të përcaktojë rolet respektive dhe përgjegjësitë, sistemin e drejtimit dhe marrëveshjet për zbatimin. Udhëzimet për Zbatimin e Projektit (UZP) do të aneksohen tek PBA për të rregulluar zbatimin e aktiviteteve, rregullat e prokurimit, monitorimin dhe raportimin. Gjithashtu, do të nënshkruhet mes dy Palëve një Marrëveshje për Kredinë e Butë (MKB), që do të specifikojë kushtet e kredisë dhe modalitetet e disbursimit financiar.

Ekzekutimi i programit AFP do të jetë nën përgjegjësinë e MMSR-së që vepron si Njësia Ekzekutive. Do të përzgjidhet dhe emërohet stafi teknik dhe administrativ brenda Programit AFP për të mbështetur MMSR-në në përgjegjësitë dhe funksionet e saj të menaxhimit. Procedurat e prokurimit të Programit do të ndjekin rregullat e BE-së lidhur me tipologjinë e ndryshme të kontratave, për shembull, Punime, Furnizime, Shërbime. Për sa i takon komponentit të Asistencës Institucionale,

Programi do të shfrytëzojë një Kontratë institucionale Binjakëzimi me një institucion publik të njohur nga Shtete Anëtare (SHA) të BE-së, që ka pasur eksperiencë efektive në sfera të inovacionit mbi AFP-në, të tilla si sistemi dual dhe transformimi i shkollave ekzistuese AFP në Qendra Multifunkionale Ekselence, dhe është më i familjarizuar me sistemin prodhues bujqësor shqiptar bazuar kryesisht në ndërmarrje të vogla e të mesme. Fisha për Kontratën e Binjakëzimit për sigurimin e asistencës teknike institucionale përshihet këtu në aneksin n. 3.

Komiteti Drejtues

Do të ngrihet një Komitet Drejtues (KD) me qëllim që të sigurojë drejtim të përgjithshëm, koordinim dhe mbikëqyrje të gjithanshme për aktivitetet nën Programin AFP. KD do të përbëhet nga përfaqësues të MMSR dhe IDC (*Italian Development Cooperation*). Mund të ftohen edhe përfaqësues të Zyrës së Kryeministrit, si dhe të Ministrive të linjës, si Ministria e Financës, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Menaxhimit të Ujërave, Ministria e Arsimit dhe Sportit për të ndjekur mbledhjet e Komitetit Drejtues (KD). Modalitetet e funksionimit të KD do të përcaktohen në GPI në aneks të PBA. Në takime, mund të ftohet edhe një përfaqësues nga Institucioni Publik MS që do të nënshkruajë Kontratën e Binjakëzimit me MMSR-në në kuadër të Programit AFP.

11. Kuadri i monitorimit dhe vlerësimi

Ngritja e GMIP mbi “Punësimin dhe Aftësitë” kontribuon në raportimin formal dhe në mekanizmat e shqyrtimit për të lehtësuar, koordinuar dhe mbikëqyrur progresin e sektorit të AFP-së dhe strategjisë. Këshilltari Rezident i Binjakëzimit do të luajë një rol themelor duke asistuar MMSR dhe Partnerët e Zhvillimit dhe Integritit në monitorimin dhe zbatimin e strategjisë (SKPA 2014-2020).

Megjithatë, brenda Programit të përgjithshëm AFP, do të vendoset një sistem i brendshëm monitorimi dhe një mekanizëm dypalësh vlerësimi, me qëllim që të ndiqet ekzekutimi i Programit dhe të kryhet një vlerësim i brendshëm, pjesë integrale e zbatimit të projektit⁴³ për aktivitetet e Programit dhe kushtet e brendshme dhe të jashtme që mund të kenë efekte mbi vetë programin, me qëllim për të verifikuar nëse rezultatet e parashikuara dhe objektivat janë të arritshme. Për më tepër, përderisa Programi është në një linjë me SKPA dhe Programin IPA II, do të kryhet një monitorim i jashtëm në mënyrë të përbashkët me Delegacionin e BE-së.

12. Qëndrueshmëria dhe Strategjia e Përmbylljes

12.1 Qëndrueshmëria ekonomike dhe financiare

Sipas sistemit ekzistues të buxhetit, kostot operative të shkollave të AFP-së për pagat e mësuesve dhe stafit administrativ, mirëmbajtjen, materialet didaktike dhe të mësuarit, si dhe ambientet, duhet të mbulohen nga buxheti i caktuar nga MMSR. Prandaj, zbatimi i Programit AFP nënkupton që MMSR është e angazhuar të vazhdojë të alokojë buxhetin vjetor operativ të nevojshëm për shkollat e AFP-së përfituese dhe për qendrat multifunkionale të AFP-së. Përveç kësaj, duke pasur parasysh strukturën e parashikuar të qendrës multifunkionale të Fierit dhe ngritjen e shërbimeve të jashtme që do i ofrohen mjedisit të biznesit, priten disa të ardhura shtesë edhe nga prodhimi i frutave dhe perimeve, qumështit dhe produkteve të tjera.

12.2 Qëndrueshmëria institucionale

Në momentin që MMSR po zbaton SKPA-në e aprovuar 2014-2020, që mbështetet mbi: “*Aftësi në nivel më të lartë dhe vende më të mira pune për të gjitha gratë dhe burrat*” duke nënkuptuar kualifikime dhe aftësi në nivel më të lartë që i përgjigjen nevojave të tregut të punës. Kjo është një nga arsytet për të mbështetur ngritjen e qendrave multifunkionale në gjithë vendin. Për më tepër, bujqësia, mbarështimi i kafshëve dhe veterinaria kanë marrë vëmendje të veçantë nga Qeveria Shqiptare pasi këto sektorë vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në ekonominë e vendit. Në fakt, MMSR u ofron nxënësve që regjistrohen në AFP bujqësore dhe veterinare një grant për katër vitet e kursit të studimit.

12.3 Qëndrueshmëria mjedisore

Punimet e rehabilitimit që janë parashikuar për dy shkolla, nuk pritet të kenë ndonjë impakt negativ

⁴³ Built-in evaluation – (shënim i përkthyesit) vlerësim jo me shifra skematike për matje ‘metrike’, por parashikon ndërtimin e një sistemi të brendshëm vetë-vlerësimi, për të ndjekur në vijimësi zbatimin e projektit. Në këtë mënyrë vlerësimi integrohet si pjesë integrale e zbatimit

mjedisor. Aktiviteti ndërtues reduktohet, pasi është kryesisht punim rehabilitimi ose ndërtim në zona ndërtësash ekzistuese.

Megjithatë disa masa kujdesi duhen parashikuar, dhe ekipi i projektimit do të marrë në konsideratë opsione të ndryshme zbatimi, duke përzgjedhur zgjidhjet që kanë më pak impakt.

Gjatë fazës së ndërtimit – kryesisht rindërtim i ndërtesave ekzistuese, me përjashtim vetëm të konvikteve – transporti i materialeve të ndërtimit dhe mbeturinave mund të jetë një shkak për ndotje, nëse nuk merren masat e nevojshme; kontraktuesit do të kenë detyrim përcaktues që të përdorin makina që respektojnë standardet e antindotjes dhe që mbulojnë si materialet që sjellin dhe ato që marrin me kanavacë mbuluese që të shmangin ndotjen. Mbeturinat mund të depozitohen në vende shkarkuese të përshtatshme, autorizuar nga autoritetet lokale. Shkatërrimet, kur të jenë të nevojshme, do të bëhen duke shmangur – sa më shumë të jetë e mundur – zhurmën dhe pluhurin.

Projektimi i ndërtesave dhe infrastrukturës relevante do të marrë parasysh aktivitetet specifike që do të zhvillohen në shkolla, sidomos në shkollën e Fierit, ku planifikohet të ndërtohet një fermë e përshtatshme me një fabrikë agro-industriale.

12.4 Teknologjitë e përshtatshme

Punimet e rehabilitimit do të respektojnë dhe të përmirësojnë standardin e cilësisë së ndërtesave ekzistuese, ndërsa do të krijohet edhe akses për personat me aftësi të kufizuara, dhe hapësira miqësore të përbashkëta për nxënës dhe mësues.

Niveli arkitektural i shkollës AFP në Fier është i varfër dhe ka nevojë për rikonstrukcion të plotë në disa pjesë.

Për të gjitha ndërtesat që do të rinovohen plotësisht, rindërtohen totalisht apo do të ndërtohen të reja, do të përdoren teknologji të thjeshta bio-klimatike, si të jetë më e përshtatshme në vendndodhje të ndryshme, për të kontrolluar klimën brenda ndërtesave.

13. Kushtet e jashtme dhe vlerësimi i riskut

Ka dy parakushte që duhen plotësuar për fillimin e Programit AFP: i) i pari është që financimi të mundësohet nga Qeveria Italiane në rrjedhën e duhur dhe sipas procedurave përcaktuara nga dy palët për disbursimin, në mënyrë që Programi AFP të mund të zbatohet në kohë; ii) Një kusht i dytë paraprak është që Ligji i ri mbi AFP-në të aprovohet dhe të hyjë në fuqi, për të siguruar si autonominë financiare edhe atë menaxheriale dhe mundësinë për shkolla AFP multifunksionale që të ofrojnë arsimi post-sekondar.

KORNIZA LOGJIKE (LOGFRAME)

	Logjika e Ndërhyrjes	Tregues	Burime informacioni	Supozime
Objektivi i përgjithshëm	Të kontribuojë për një treg pune më gjithëpërfshirës dhe më efektiv, duke mbështetur politika aktive punësimi dhe zhvillimin e aftësive të forcës punëtore.	Ulet shkalla e papunësisë së të rinjve Ulet hendeku gjinor në punësim	INSTAT Shqipëri -Studimi për Forcën Punëtore Viti referencial 2013: 28.2% INSTAT Shqipëri - Studimi për Forcën Punëtore Viti referencial 2013: 13.8%	Ekonomia shqiptare është stabil; vazhdon si prioritet i lartë, mbështetja buxhetore dhe politike për Qeverinë Shqiptare për përmirësimin e rezultateve të punësimit për njerëzit si në qytet dhe në fshat nëpërmjet investimeve strategjike formimin e aftësive bazë dhe të nivelit të mesëm. Rreziqe: Nuk zbatohen politika dhe Rregulloret; Në një masë të madhe, popullsia nënvlerëson trajnimin AFP si dhe profesionet me të cilat lidhet Ekonomia fillon spirale zbritëse në recesion
Objektivi specifik	Logjika e Ndërhyrjes Të ngrihet një shkollë e plotë multifunkionale AFP ekselence në sektorët e bujqësisë dhe përpunimit agro-ushqimor në shkollën “Rakip Kryeziu” në Fier dhe ndërhyrje specifike në Shkollën në Lushnje në lidhje me mekanizimin bujqësor.	Tregues Ndërtohet 1 shkollë multifunkionale AFP (Fier), përveç shkollave multifunkionale AFP mbështetur nga IPA 2014-2020 në sektorin AFP 1 shkollë AFP e kualifikuar sipas nevojave të tregut të punës së mekanikës bujqësore. Rritet proporcioni i nxënësve femra dhe meshkuj që ndjekin Arsimin dhe Formimin Profesional në shkollat që ndodhen në zonat rurale. Rritja e shkallës së punësimit e të diplomuarve në arsimin profesional	Burime informacioni Dokumenti i Veprimt IPA II – Delegacioni i BE-së në Shqipëri Studimi për Forcën Punëtore Viti referencial 2012: 15.7%	Supozime MMSR zbaton reformat në sektor Bashkëpunimi me industrinë në kualifikimet dhe standardet kombëtare Rreziqet Interes i ulët i nxënësve djem e vajza për AFP
Rezultatet e pritshme		Tregues	Burime informacioni	Supozime
Rezultati 1	Qendra multifunkionale bujqësore e ekselencës e menaxhuar dhe organizuar; Përmirësohet dhe organizohet shkolla AFP në Lushnje.	Nënshkrimi i Kontratës së Binjakëzimit Njësitë e ndërtuara dhe rindërtuara dhe grafiku i kohës Mallrat e blera korrespondojnë me listat e detajuara, përgatitur në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme Rritje me të paktën 20 % të numrit total të mësuesve në aktivitetet e reja të trajnimit në çdo shkollë. Rritje me të paktën 20 % të numrit total të regjistrimeve të nxënësve në kurset e çdo shkolle Një plan trajnimi i përgjithshëm aprovuar çdo vit akademik -	Raportet e tenderimit Raportet e programeve Marrëveshjet Proces-verbalet e mbledhjeve të Komitetit Drejtues Kontroll dhe testim final i njësive të blera Raportet e monitorimit dhe vlerësimit	Nuk ka kufizime administrative Personel i motivuar Nuk ka vonesa në aprovimin e planeve të punës

Rezultati 2	Zhvillohen dhe zbatohen kurrikula AFP dhe të orientuara nga tregu i punës	Zhvillohen dhe aplikohen të paktën 4 kurrikula në nivel arsimi i mesëm për shkollën e Fierit çdo vit. Zhvillohen dhe aplikohen të paktën 2 kurrikula në nivel post-sekondar për vitin e dytë dhe të tretë për shkollën e Fierit. Zhvillohen dhe aplikohen të paktën 4 kurrikula për kurse afat-shkurtra për vitin e dytë dhe të tretë për shkollën e Fierit. Zhvillohet dhe aplikohet të paktën 1 kurrikulë në nivel arsimi të mesëm për çdo vit në shkollën e Lushnjës. Zhvillohen dhe aplikohen të paktën 2 kurrikula për kurse afat-shkurtra për vitin e dytë dhe të tretë për shkollën e Lushnjës.	Raportet e programit Analizë e pyetësorit	Kurrikulat dhe planet mësimore janë të përshtatshme sipas kërkesave të tregut.
Rezultati 3	Ndërtohet marrëdhënie e qëndrueshme dhe e përshtatur sipas kontekstit specifik e AFP multifunksionale me sektorin privat	Prania e përfaqësuesve të sektorit privat në bordin e AFP Arrihet marrëveshja dhe zbatohet Pakti AFP. Të paktën 50 % e kurrikulave të ofruara organizohen mbi bazë duale (të paktën 30 % e praktikave profesionale në vendin e punës). Të paktën 50 nxënës (si në Fier dhe në Lushnje) hyjnë çdo vit në tregun e punës. Ngrihet ndërmarrja bujqësore e shkollës AFP (Fier). Kërkohen të paktën 5 kontrata shërbimi nga ndërmarrja bujqësore e shkollës AFP (Fier).	Raportet e Bordit Nënshkruhet Pakti	Përfshirja e sektorit privat në zhvillimin e AFP multifunksional
Rezultati 4	Sigurohet koherencë me financimin IPA II	Zbatim sinergjik i Programi AFP në koherencë me financimin e IPA II	Raporte të përbashkëta monitorimi dhe vlerësimit	Financimi i Programit siç pritet

	Logjika	Produkte	Burime	Supozime
Aktivitetet e Rezultatit 1	1.1.1 Identifikim i punimeve 1.1.2 Zhvillimi i Konceptit të Projektit Infrastruktural 1.1.3 Përgatitje dhe redaktim i dokumenteve të tenderimit 1.1.4 Nënshkruhet dhe zbatohet kontrata e punimeve 1.1.5 Mbikëqyrje punimesh 1.1.6 Testimi final 1.2.1 Përgatitje dhe redaktim i tenderimit 1.2.2 Kontratë furnizimi për blerjen e laboratorëve dhe pajisjeve 1.2.3 Kontrata furnizimi për blerjen e automjeteve bujqësore dhe veglave bujqësore, 1.2.4 Kontrata furnizimi për blerjen e mobilie 1.2.5 Kontrata furnizimi dhe blerjen e materialeve didaktike 1.3 Bordi Drejtues i Shkollës 1.4 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore 1.5 Program i Përgjithshëm Trajnimi 1.6 Shërbim Karriere 1.7 Sigurimi i Cilësisë 1.8 Akreditimi dhe certifikimi	Sigurohet Kontrata e Binjakëzimit Sigurohet kontrata për punimet infrastrukurale Sigurohet kontrata për laboratorët, pajisjet, mobilitet, makineritë bujqësore, materialet didaktike dhe inputet bujqësore		MMSR siguron personelin e duhur në të gjitha nivelet. Palët bien dakord për procedurat e tenderimit dhe kontraktimit.
Aktivitetet e Rezultatit 2	2.1 Zhvillimi dhe përcjellja e kurrikulave të nivelit të arsimit të mesëm 2.2 Zhvillimi dhe përcjellja e kurrikulave afatshkurtra 2.3 Zhvillimi dhe përcjellja e kurrikulave të nivelit post-sekondar 2.4 Trajnimi i trajnerëve	Sigurimi i Kontratës së Binjakëzimit		Asistenca teknike e binjakëzimit mbështetet në funksionin e vet nga MMSR
Aktivitetet e Rezultatit 3	3.1 Shërbime shkollore për palë të treta 3.2 Pilotimi i PTAFP	Sigurimi i Kontratës Binjakëzimit		Menaxhimi i shkollave AFP kryhet në mënyrë eficiente
Aktivitetet e Rezultatit 4	4.1 Menaxhimi i Programit 4.2 Shërbime teknike 4.3 Shërbime prokurimi 4.4 Komunikimi dhe vizibiliteti	Përzgjedhja e personelit për të mbështetur MMSR Sigurohet Kontrata e Binjakëzimit (Këshilltari Rezident për Binjakëzimin)		Palët bien dakord mbi procedurat e rekrutimit

Hyrja në fuqi e Ligjit të ri të Reformës për AFP është një parakusht për zbatimin e Programit për të siguruar autonominë financiare dhe menaxheriale të shkollave AFP përfuturse dhe prezantimin e AFP post-sekondar

ANEKS 2

Plani Financiar			Shuma (në Euro)	Fier	Lushnje	Komponentët e projektit (A=Infrastruktura; B=Laboratorë & Pajisje; C=Asistencë Teknike Institucionale; D= Asistencë e MMSR
		Rezultati 1	3.755.000,00			
1.1	1.1.1	Identifikim i punimeve	25.200,00	12.600,00	12.600,00	A
	1.1.2	Zhvillimi i Konceptit të Projektit Infrastruktural	40.000,00	30.000,00	10.000,00	A
	1.1.3	Përgatitje dhe redaktim i dokumenteve të tenderimit	25.200,00	12.600,00	12.600,00	A
	1.1.4	Nënshkruhet dhe zbatohet kontrata e punimeve	1.122.600,00	1.000.000,00	122.600,00	A
	1.1.5	Mbikëqyrje punimesh	40.000,00	30.000,00	10.000,00	A
	1.1.6	Testimi final	10.000,00	5.000,00	5.000,00	A
1.2	1.2.1	Përgatitje dhe redaktim i dokumenteve të tenderimit	40.000,00	30.000,00	10.000,00	B
	1.2.2	Kontratë furnizimi për blerjen e laboratorëve dhe pajisjeve	1.400.000,00	1.250.000,00	150.000,00	B
	1.2.3	Kontrata furnizimi për blerjen e automjeteve bujqësore dhe veglave bujqësore	400.000,00	350.000,00	50.000,00	B
	1.2.4	Kontrata furnizimi për blerjen e mobilieve	200.000,00	170.000,00	30.000,00	B
	1.2.5	Kontrata furnizimi dhe blerjen e materialeve didaktike	200.000,00	180.000,00	20.000,00	B
1.3		Bordi Drejtues i Shkollës	126.000,00			C
1.4		Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	25.200,00			C
1.5		Program i Përgjithshëm Trajnimi	25.200,00			C
1.6		Shërbim Karriere	25.200,00			C
1.7		Sigurimi i Cilësisë	25.200,00			C
1.8		Akreditimi dhe certifikimi	25.200,00			C
		Rezultati 2	151.200,00			
2.1		Zhvillimi dhe përcjellja e kurrikulave të nivelit të arsimit të mesëm	37.800,00			C
2.2		Zhvillimi dhe përcjellja e kurrikulave afatshkurtra	37.800,00			C
2.3		Zhvillimi dhe përcjellja e kurrikulave të nivelit post-sekondar	37.800,00			C
2.4		Trajnimi i trajnerëve	37.800,00			C
		Rezultati 3	201.600,00			
3.1		Shërbime shkollore për palë të treta	126.000,00			C
3.2		Pilotimi i PTAFP	75.600,00			C
		Rezultati 4	892.200,00			
4.1		Menaxhimi i Programit				
4.1.1		Menaxheri i projektit	72.000,00			D
4.1.2		Drejtuesi i projektit (ndërkombëtar)	216.000,00			C
4.1.3		Asistent projekti	28.800,00			C
4.1.4		Financier/administrativ	46.800,00			C
4.1.5		Teknik/agronom	36.000,00			C
4.1.6		Oficer për ndërlidhjen Shkollë-ndërmarrje	36.000,00			C
4.1.7		Përkthyes	28.800,00			C
4.1.8		shofer/asistent logjistike	21.600,00			C
4.1.9		Blerje makine	25.000,00			C
4.1.10		Mirëmbajtje makine	18.000,00			C

4.1.11		Materiale zyre dhe të tjera të nevojshme	14.000,00			C
4.1.12		Bileta udhëtimi/fluturimi	43.200,00			C
4.2		Shërbime teknike				
4.2.1		Këshilltari rezident i binjakëzimit (ndërkombëtar)	216.000,00			C
4.3		Shërbime prokurimi				
4.3.1		Oficer i prokurimit	54.000,00			D
4.4		Strategjia e komunikimit dhe veprimet për vizibilitetin				
		Oficer për komunikimin	36.000,00			D
TOTAL			5.000.000,00			

Aneksi 3

FISHA STANDARD E KONTRATËS SË BINJAKËZIMIT

Programi në mbështetje të AFP-së nëpërmjet Inovacionit

1. Informacion Bazë

1.1 Programi:

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI)

1.2 Kandidatë të përshtatshëm për tenderim: Çdo institucion publik i BE-së që është përgjegjës për programimin, buxhetimin dhe zbatimin e politikave AFP në territorin e kompetencës së tyre.

1.3 Titulli:

Program në mbështetje të AFP-së nëpërmjet Inovacionit

1.4 Sektori:

Punësimi dhe Aftësitë

1.5 Institucioni përfitues:

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR)

2. Objektivat

2.1 Objektivi i Përgjithshëm:

Objektivi i përgjithshëm i Binjakëzimit është të mbështesë MMSR-në për të ngritur një Qendër bujqësore multifunkionale të Arsimit dhe Formimit Profesional në Rajonin e Fierit në Shqipëri, me qëllim që të rritet punësueshmëria e të diplomuarve nga sistemi AFP dhe për të kontribuar për konkurrueshmërinë e vendit në sektorët e bujqësisë dhe përpunimit agro-ushqimor.

2.2 Qëllimi i projektit:

Qëllimi i kësaj Kontrate të Binjakëzimit është të rrisë kapacitetin institucional të MMSR-së që të zhvillojë një qendër multifunkionale AFP, duke ndërtuar një sistem dual, që sjell përmirësim të aftësive të përfutuara, që u përgjigjet nevojave të tregut të punës, dhe një sistem të qëndrueshëm të konsoliduar për të monitoruar dhe vlerësuar rritjen e punësimit në sektorin e bujqësisë.

3. Përshkrimi

3.1 Sfondi dhe justifikimi:

Kjo Kontratë Binjakëzimi do të fokusohet në zhvillimin e kapacitetit të MMSR-së dhe shkollave AFP në Rajonin e Fierit me terma të një parashikimi afatgjatë të tregut të punës, si dhe në monitorimin dhe vlerësimin e rritjes së punësimit në sektorin bujqësor. Përkatësisht, me qëllim që të përballohen me sukses sfidat në tregun e punës, MMSR me palët e tjera të interesit, kanë nevojë që të përmirësojnë në mënyrë progresive kapacitetet e tyre për të përmbushur vizionin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA) 2014-2020 për ta pasur një ekonomi konkurruese dhe një shoqëri gjithëpërfshirëse që bazohet në aftësi në nivel më të lartë dhe vende më të mira pune për të gjithë gratë dhe burrat deri në 2020.

3.1.1 Sfondi social dhe ekonomik

3.1.1.1 Sfondi ekonomik

Gjatë viteve të fundit Shqipëria ka mbetur një nga ekonomitë në rritje në Europë. Rritja ka qenë rezultat i transformimeve strukturore, bazuar gjerësisht në lëvizjen e punës nga punësimet bujqësore me produktivitet të ulët në shërbime, ndërtim, dhe në një shkallë më të vogël – në prodhim industrial. Në periudhën 2001-2011, Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) për banor u rrit dy herë (deri në US\$4,555) duke arritur në nivelin e 31 për qind të mesatares së Bashkimit Europian.⁴⁴ Kjo rritje ekonomike u shoqërua me politika fiskale dhe makroekonomike stabël, reforma strukturore për të përmirësuar mjedisin e biznesit dhe investimet në infrastrukturë, teknologji dhe burime njerëzore. Si rezultat, produktiviteti i punës u rrit me një mesatare prej 6.4 për qind në bazë vjetore.

Raporti i Bankës Botërore nënvizon se Shqipëria ‘Duke e kapërcyer 6% për vit mesatarisht, ishte ekonomia rritëse më e shpejtë në Europë në dekadën që çoi drejt krizës financiare globale në 2008. [...] Kjo performancë e fortë rritjeje nënkuptonte që Shqipëria, që ishte vendi më i varfër i Europës në fillim të viteve 1990, arriti një status me të ardhura mesatare në 2008. [...] Në vitet e lulëzimit ndërmjet 2002 dhe 2008, rritja ngriti shumë njerëz prej varfërisë, dhe shkalla e varfërisë u ul nga 25.4 për qind në 12.5 për qind. Rritja ekonomike ishte gjithëpërfshirëse, me konsum mes 40 për qind të pjesës së poshtme në shpërndarjen e popullsisë (40 përqindshi i poshtëm) që u rrit më shpejt se mesatarja për vendin.’⁴⁵

Rritja u inkurajua në shkallë të madhe nga konsumi i brendshëm në rritje, kryesisht i përcaktuar nga hopi i lulëzimit në pronat pasuri e patundshme, dhe nga remitancat e emigrantëve, me një zhvendosje nga bujqësia rurale në sektorët urbanë. Megjithatë ky ndryshim në strukturën e ekonomisë nuk çoi drejt një rritje në produktivitetin total, që ka qenë në stanjacion që nga viti 2000, dhe në punësimin formal që ra nga 73% në 2000 tek 58% në 2008.

Pas krizës ekonomike globale, ‘Rritja ekonomike e Shqipërisë pati një mesatare nën 3% në vit në terma realë ndërmjet 2009 dhe 2012, duke u zhytur tek një mesatare prej vetëm 1.7% në vit në 2013 dhe 2014.’⁴⁶ Impakti i krizës rezultoi në rrudhjen e kërkesës për forcë punëtore dhe shkalla e varfërisë qëndroi tek 14.3% në 2012. Në 2013, me 7% të popullsisë që jetonte nën nivelin e varfërisë prej \$2.50-në-ditë, Shqipëria ishte vendi i katërt më i varfër në Europë⁴⁷. Kriza e vitit 2008 nxori në pah kufizimet e modelit të rritjes që varej nga flukset e huajani konsum të brendshëm financiar, investim dhe në fund rritje.

Është bërë e nevojshme një politikë shumë-planëshe për të riorientuar ekonominë drejt sektorëve inovatorë dhe produktivë nëpërmjet: i) një klime biznesi të cilësisë së lartë, rritjes solide dhe krijimit të vendeve të punës; ii) infrastrukturave të përshtatshme fizike; iii) përmirësimit të cilësisë së burimeve njerëzore, që të arrijë në nivel të nevojave për sektorët inovatorë, me një forcë punëtore me aftësi të shkallës së lartë; iv) mundësia dhe prania e shërbimeve të duhura të biznesit dhe instrumente financiare mbështetëse.

Marrja e masave për inovacion është thelbësore për të tërhequr Investime e Huaja Direkte (IHD) në sektorë që kanë më shumë vlerë të shtuar,⁴⁸ për të inkurajuar Investimet e Brendshme Direkte (IBD), për të promovuar inovacionin produkt/proces, hapjen e bizneseve të reja, përballimin e sfidave të një tregu të hapur dhe reduktimin e papunësisë së të diplomuarve të rinj.

⁴⁴ INSTAT, *Prodhimi i Brendshëm Bruto në Republikën e Shqipërisë*, Gusht 2012 tek

http://www.instat.gov.al/media/101280/llogarite_rajonale_4faqeshi_ang_.pdf; World Bank, *World development indicators (Treguesit e zhvillimit botëror)*, 2001-2010, tek <http://data.worldbank.org/data-catalog>; EUROSTAT, *News release 97/2012*, tek

http://epp.eurostat.ec.europa.eu/cache/ITY_PUBLIC/2-20062012-AP/EN/2-20062012-AP-EN.PDF.

⁴⁵ Grupi i Bankës Botërore, Prill 2015, *Shqipëria e Brezit Tjetër – Një diagnozë sistematike e vendit*, p. i.

⁴⁶ Po aty.

⁴⁷ Banka Botërore, *Përlllogaritjet ECATSD duke përdorur të dhënat ECAPOV*. Varfëria matet duke përdorur konsumin në nivelin e varfërisë tek \$2.50-në-ditë, rreth 2012. Pavarësisht ngadalësimit në ekonomi, pabarazia, e matur nga treguesi Gini, mbeti gjerësisht e pandryshuar. Treguesi Gini ishte 26.9 në 2012, krahasuar me 28.2 në 2008.

⁴⁸ Flukset e Investimeve të Huaja Direkte janë reduktuar pothuajse përgjysmë në vitet e fundit, kryesisht për shkak të një rënie në investime nga investitorë tradicionalë të BE-së që kanë përjetuar stres ekonomik në vendet e veta

3.1.1.2 Tregu i Punës

Rritja ekonomike e regjistruar gjatë dekadës së fundit pati një impakt të kufizuar në punësim. Bujqësia mbetet akoma operatori kryesor i punësimit, ndonëse pati një tendencë ulëse krahasuar me vitin 2000. Në 2012, sektori bujqësor regjistronte 47.4 për qind të punësimit total, dhe sidomos për gratë (58.4 për qind e grave të punësuar punonin në bujqësi krahasuar me shifrën 43.1 për qind të meshkujve). Punësimi në sektorin e shërbimeve përfaqësonte 36.1 për qind të punësimit total, ndërsa industria punësonte 16.5 për qind të të gjithë punëtorëve, dhe meshkujt figuronin në shifra dy herë më të larta për punësim në industri krahasuar me gratë.⁴⁹

Shkalla e papunësisë është rritur më tej në 17.9 % në 2014, dhe shumica e personave të papunë rezultojnë se kanë nivele të ulëta arsimimi. Ndër grupmoshën 15-29 vjeç, shkalla e papunësisë shkon deri në 32.5 % (16.4% meshkuj / 23.6% femra). Në lidhje me çështjet gjinore, ka akoma diferenca të konsiderueshme gjinore në tregun shqiptar të punës, mesatarisht, hendeuku është rreth 15 pikë për punësimin e femrave dhe meshkujve⁵⁰. Në tremujorin e parë të 2015, të rinjtë e papunë ishin 34.1%.

Tregu i Punës në Shqipëri në Shqipëri ka vazhduar të evoluojë dhe të përshtatet me kushtet e tregut në ndryshim, por jo aq shpejt apo në mënyrë fleksibël sa duhet. Tregu i punës akoma dominohet nga aktiviteti bujqësor privat i pakualifikuar dhe proporcioni i forcës punëtore në industri dhe në shërbime është shumë më poshtë se nivelet e vendeve të tjera në Europën Juglindore dhe Bashkimin Europian.

Në terma të pjesëmarrjes në forcën punëtore, shkalla e punësimit për popullsinë në moshë 15-64 vjeç, u ul nga 55.9% në 2012 drejt 52.1% në fillim të vitit 2015. Shkalla e përgjithshme e papunësisë në 2014 mbeti tek 17.9%, e rritur ndjeshëm në krahasim me 13.5% në 2007. Megjithatë, papunësia ishte në thelb më e lartë për të rinjtë 15-29 vjeç (nga 19.8% në 2007 drejt 32.5% në 2014). Në tremujorin e parë të vitit 2015, të rinjtë e papunë mbetën në nivel 34.1%.

Një tjetër aspekt kyç i tregut shqiptar të punës është proporcioni relativisht i lartë i inaktivitetit, që u rrit me 4.9% në 2013, dhe rezultoi në 1.6 herë më i lartë për gratë në krahasim me shifrën përkatëse për burrat, që ka tendencë të përforcojë stereotipin e femrave që konsiderohen si mbajtëset dhe kujdestaret e familjes.⁵¹

Së fundi, tregu i punës në zonat rurale është një territor i panjohur që përballet me sfida të mëdha krahasuar me zonat urbane. Zonat rurale janë karakterizuar kryesisht nga forcë punëtore me aftësi të ulëta, mundësi të kufizuara, që mbështet fort në mbijetesën bujqësore dhe ka nivele të larta varfërie.⁵²

3.1.1.3 Arsimi dhe Formimi Profesional (AFP)

Ata që kryejnë arsimin profesional janë në nivel dominues meshkuj, sidomos në vitet e fundit, që tregun se arsimi profesional është kapur kryesisht nga meshkujt. Arsytet për këtë fenomen me orientim të theksuar gjinor janë të ndryshme. Nga ana e ofertës, faktorët që dekurajojnë vajzat (dhe prindërit e tyre) që të zgjedhin arsimin profesional përfshijnë kurse dhe profile me stereotipe gjinore të rrënjosur thellë, vendndodhja e shkollave AFP, mungesa e transportit, konviktet e pasigurta dhe klima e përgjithshme sociale në shkollat e AFP.⁵³

Arsimi dhe Formimi Profesional ka potencial që të ndikojë në mënyrë pozitive integrimin në tregun e punës dhe gjenerimin e të ardhurave. Në periudhën 2009-2013, AFP ofrohej nëpërmjet një sistemi të centralizuar. Sistemi nuk ka qenë i aftë të përmbushë nevojat lokale kryesisht për shkak të

⁴⁹ INSTAT, *Tregu i Punës 2011-2012*.

⁵⁰ INSTAT, *Studimi i Forcës Punëtore*, 2015

⁵¹ Sipas përcaktimeve të INSTAT/Studimi i Forcës Punëtore: Popullsia aktive jo-ekonomike përfshin të gjithë personat që nuk klasifikohen si të punësuar ose të papunë (nxënës/studentë, punëtore shtëpiake, në një shërbim ushtarak të detyruar, pensionistë, invalidë, të papunë të dekurajuar). Shihni <http://www.INSTAT.gov.al/en/themes/labour-market.aspx>.

⁵² Studimi Kombëtar mbi Tregun Rural të Punës, UNDP Albania, Ref: UNDP/Duke trajtuar Përfshirjen Sociale nëpërmjet Arsimit dhe Formimit Profesional (*Addressing Social Inclusion through Vocational Education and Training*)

⁵³ Analiza Gjinore e Programit të Zhvillimit të Burimeve Njerëzore dhe e sektorit të AFP-së në Shqipëri e GIZ, 2011.

ndarjes mes arsimit dhe formimit profesional dhe një qasje të papërshtatshme për monitorim dhe vlerësim⁵⁴. Kjo ka rezultuar në një nivel të ulët (14.2%) pjesëmarrje në arsim dhe formim profesional gjatë kësaj periudhe. Formimi për të rriturit në Shqipëri është akoma në nivele foshnjore, me vetëm afro 1% të të rriturve të moshës 25-64 vjeç në programet e trajnimit dhe ritrajnimet profesionale gjatë 2012 (krahasuar me 9% në vendet e BE-së). Në vitin aktual shkollor 2014/15, janë regjistruar rreth 6,000 nxënës në shkollat profesionale, një rritje e konsiderueshme prej 40% krahasuar me nivelet e 2013/14⁵⁵.

Në sferën e AFP, ka bashkëpunim të kufizuar mes institucioneve që kryejnë formim profesional dhe bizneseve si punëdhënës potencialë. Kjo kufizon potencialin për të rritur punësimin pas përfundimit të arsimit dhe formimit profesional. Për të rinjtë, shkalla e interesit dhe atraktivitetit të AFP-së është e ulët, dhe ata e perceptojnë atë si opsionin e dytë më të mirë për të arritur tek arsimi i lartë, dhe jo si një rrugë për të hyrë në tregun e punës. Formimi për të rriturit është në faza foshnjërie, me vetëm një për qind të të rriturve (25-64 vjeç) në formimin profesional dhe programet e ritrajnimit në 2012 (krahasuar me 9% në BE). Si pasojë, aftësitë që merren nëpërmjet AFP-së nuk përputhen me nevojat në tregun e punës, duke rezultuar në mungesa për aftësi profesionale në disa sfera dhe superprodhim në aftësi në disa të tjera⁵⁶.

Prandaj, sistemi shqiptar i AFP-së akoma ndikohet nga: (i) përfshirja e kufizuar e partnerëve socialë – në veçanti, marrëdhëniet mes sistemit të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe industrisë janë të dobëta; (ii) shumica e kurrikulave ofrojnë pak fushëpamje për eksperiencë pune të prekshme dhe nuk lidhen me standardet profesionale dhe ato të kualifikimit; (iii) aspektet e praktikës profesionale janë të kufizuara, përfshirë edhe në kurrikulat e AFP-së; (iv) një sistem i centralizuar në shkallë të lartë dhe me cilësi të ulët (më shumë se 60% e operatorëve publikë të AFP-së konsiderohen si performues të ulët ose të dobët me përgjegjshmëri të ulët ndaj nevojave lokale); (v) mungesë mësuesish të aftë dhe programe trajnimi për mësuesit (gjatë diplomimit dhe më pas në vazhdim të eksperiencës së punës); (vi) një hendek mes arsimit profesional dhe formimit profesional; (vii) qendrat e formimit profesional janë larg të qenit eficientë dhe që të përmbushin misionin e tyre; (viii) të nënfinancuara, me stimuj nxitës të varfër për pjesëmarrjen e punëdhënësve; dhe (ix) ambiente, kompetenca të stafit trajnues, kurrikula dhe infrastrukturë të kufizuar në Arsimin dhe Formimin Profesional.

3.1.1.4 Bujqësia

Bujqësia vazhdon të jetë në Shqipëri një nga sektorët më të rëndësishëm ekzistues dhe për zhvillimin potencial në të ardhmen. Sipas INSTAT-it, në 2013 ajo përbënte 18.3% të PBB, dhe mbetet sektori parësor për punësim, me afro 52% të të punësuarve me kohë të plotë. Gjatë periudhës 2007–2014 eksportet u rritën me 125.6% dhe importet me 44.6%. Në të njëjtën periudhë, prodhimi bujqësor u rrit me 25.5% dhe prodhimi agro-industrial u rrit me afro 32.1%. Në sferën e menaxhimit të tokës bujqësore, sipërfaqja e tokës nën prodhim u rrit me më shumë se 20,000 hektarë krahasuar me nivelet e vitit 2007. Aktualisht, afërsisht 2/3 e totalit të tokës bujqësore të disponueshme është në përdorim⁵⁷.

Grafiku i mëposhtëm tregon të dhënat e disponueshme të regjistrimit të fundit të strukturës së ekonomisë shqiptare, duke marrë në konsideratë dy aspekte: i) përbërjen e PBB sipas sektorëve; ii) forcën punëtore sipas profesionit.

*Tabela 1
Burimi: INSTAT, Regjistrimi 2011*

⁵⁴ Aftësitë 2020 Shqipëri (Skills 2020 Albania), European Training Foundation, Dokument pune, Tetor 2014

⁵⁵ Po aty

⁵⁶ Po aty

⁵⁷ Ministria e Bujqësisë, *Strategjia e Integruar për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural 2014-2020*

	Bujqësia	Industria	Shërbimet
Përbërja e PBB sipas sektorëve (2011 est.)	19.5%	12.0%	68.5%
Forca punëtore – sipas profesionit (2011 est.)	54.6%	12.8%	32.6%

Këto të dhëna tregojnë sa joproduktiv dhe i pazhvilluar është tregu i punës në Shqipëri dhe nevojën urgjente për të ndërhyrë në mënyrë eficiente në kualifikimin e forcës punëtore.

Për t’iu përgjigjur këtyre sfidave, në fund të vitit 2014 u aprovua “*Strategjia e Integruar për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural - SIBZHR 2014-2020*” nga Këshilli i Ministrave.

Mjeti kryesor ndaj sfidave afatgjata në sektorin e bujqësisë duhet të marrë parasysh nevojën për t’iu adresuar niveleve të ulëta të produktivitetit bujqësor dhe nivelit të pazhvilluar të rajoneve rurale.

Vizioni i SIBZHR synon “*Një sektor afro-ushqimor të qëndrueshëm, eficient, inovator, të aftë për të përballuar presionin e tregut të BE-së dhe zona rurale produktive që çojnë drejt aktiviteteve ekonomike dhe mundësive të punësimit, përfshirjes sociale dhe cilësisë së jetës për banorët e zonave rurale*”

Prandaj një nga prioritetet më të larta të SIBZHR 2014-2020 është promovimi i cilësisë dhe prodhimit të qëndrueshëm ushqimor duke zhvilluar një sektor agro-ushqimor konkurrues dhe inovator që është i aftë të përballojë presionet e konkurrencës.

Nxitja e të mësuarit gjatë gjithë jetës nëpërmjet trajnimit profesional dhe përfutimit të aftësive në zonat rurale është për më tepër në thelb të politikës kombëtare të Zhvillimit Rural siç tregohet në seksionin 3.1.4 të SIBZHR 2014-2020 “*Transferimi i njohurive dhe inovacionit në bujqësi, pyje dhe zona rurale dhe asistencë në zbatimin e politikave të zhvillimit rural*”

Më qëllim që të trajtohen këto përparësi, Shqipëria ka nevojë të përmbushë standardet dhe kërkesat e tregut të BE-së deri në 2020 nëpërmjet si më poshtë:

Duke synuar si objektiv të paktën një rritje vjetore 8% në produktivitetin e punës bujqësore, për njësinë vjetore të punës (NJVP) / të punësuarit me kohë të plotë, si dhe duke kualifikuar aftësitë e forcës punëtore;

Duke siguruar që të gjitha fermat dhe operatorët e regjistruar agro-përpunues janë në përputhje të plotë me standardet e BE-së (aplikimi i standardeve për 80% të të gjithë fermave dhe operatorëve të regjistruar agro-përpunues sipas normave të BE-së);

Rritja e madhësisë mesatare të fermave me të paktën 2.5 hektarë dhe rritje e mesatares së fermave komerciale me 3.5 hektarë;⁵⁸

Përmirësim i organizimit të zinxhirit të vlerave nëpërmjet krijimit të 100 shoqatave dhe grupeve të prodhuesve dhe tipa të ngjashme bashkëpunimi mes fermerëve;

3.1.2 Politikat Kombëtare

3.1.2.1 Vizioni i qeverisë – Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim - SKZHI 2015-2020 përcakton qartë vizionin kombëtar shqiptar:

“Shqipëria – një demokraci në forcim, në rrugën e integritit me Bashkimin Europian, me një ekonomi konkurruese, stabil dhe të qëndrueshme, dhe me garancitë për liritë dhe të drejtat themelore të njeriut”

Për të arritur këtë mision, SKZHI ka identifikuar mes të tjerash, prioritetet e mëposhtme:

Prioriteti 4: Sigurimi i rritjes nëpërmjet rritjes së konkurrueshmërisë dhe inovacionit

Prioriteti 5: Investimi tek Njerëzit dhe në Kohezionin Social

Këto prioritete do të trajtohen, ndër të tjerash, nëpërmjet:

⁵⁸ Madhësia e një ferme përfshin edhe sipërfaqen e dhënë me qera për një periudhë afat-gjatë.

Kërkimit dhe novacionit të tillë që të mund të përballojnë me sukses sfidat e të ardhmes;
Një shoqëri bazuar në dije dhe informacion;
Një sistem arsimor modern që ka në qendër interesat dhe nevojat e nxënësve/studentëve;
Mundësi punësimi më të mëdha për të gjithë gratë dhe burrat në Shqipëri.

3.1.2.2 Politikat dhe Strategjitë e AFP-së

Dokumenti shqiptar i politikave mbi AFP është Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA) 2014-2020, aprovuar në Tetor 2014 nga MMSR dhe Këshilli i Ministrave. Vizioni i SKPA 2014-2020 – frymëzuar nga qëllimi i përgjithshëm i Europa 2020 për të mundësuar rritje inteligjente, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse – është që deri në 2020, të arrihet një ekonomi konkurruese dhe një shoqëri gjithëpërfshirëse që bazohet mbi një truall me: *“Aftësi në nivel më të lartë dhe vende pune më të mira për gjithë gratë dhe burrat”*.

Synimi i përgjithshëm i Strategjisë është të nxisë vende pune me cilësi dhe mundësi për aftësi profesionale për të gjithë gratë dhe burrat në Shqipëri gjatë gjithë ciklit të jetës. Kjo do të arrihet nëpërmjet veprimeve të politikave koherente dhe të harmonizuara që trajtojnë në mënyrë të vazhdueshme boshllëqet në kërkesën e punës, ofertën e punës dhe gjithë-përfshirjen sociale. Strategjia për Punësim dhe Aftësi mbështetet në katër prioritetet strategjike, si më poshtë:

- i. Të nxisë mundësi punësimi të denja nëpërmjet politikave efikase për tregun e punës;
- ii. Të ofrojë Arsim dhe Formim Profesional cilësor për të rinj dhe të rritur;
- iii. Të inkurajojë gjithë-përfshirjen sociale dhe kohezionin territorial;
- iv. Të forcojë qeverisjen e tregut të punës dhe sistemet e kualifikimit.

Objektivi kryesor i SKPA 2014-2020 është identifikimi dhe konceptimi i politikave të duhura për të nxitur punësimin përfshirë edhe formimin profesional të forcës punëtore me qëllim që të krijojë vende pune cilësore dhe mundësi për aftësi profesionale përgjatë gjithë ciklit të jetës së tyre.

Një nga prioritetet kryesore që has objektivi i sipërpërmendur është të sigurojë Arsim dhe Formim Profesional (AFP) cilësor për të rinj dhe të rritur nëpërmjet:

Rritjes prej 25% të numrit të pjesëmarrësve në programet e AFP-së dhe optimizimit të operatorëve të rrjetit të AFP-së;

Rritjes së cilësisë dhe efektivitetit të operatorëve të AFP-së nëpërmjet sigurimit të mbështetjes financiare dhe përshtatjes së inputeve dhe kapaciteteve të AFP-së (laboratorë, pajisje, kurrikulat, materiale mësimore, burime njerëzore);

Forcimi i lidhjeve mes studimit dhe punës, dhe koordinimi i kalimit drejt punës, duke përmbushur synimet e mëposhtme.

- i. Një rritje prej 40% në shkallën e punësimit të personave që përfundojnë arsimin profesional, 25% e të cilëve të jenë femra;
- ii. Një rritje prej 55% në nivelet e punësimit ndërmjet pjesëmarrësve në formimin profesional, prej të cilëve 75% duhet të jenë gra; dhe
- iii. Nxitje më e madhe e imazhit të AFP-së.

Një tjetër dokument kyç mbi punësimin dhe aftësitë profesionale është “Mbështetja për Sektorin e Punësimit dhe Aftësive në Shqipëri” Dokument i Veprimit të BE-së për Mbështetjen Buxhetore Sektoriale në kuadër të Instrumentit për Asistencë në Para-Aderim (IPA II) 2014-2020, mbi të cilën do të mbështetet Programi AFP për sa i përket objektivave dhe treguesve. Dokumenti i Veprimit që është përgatitur për mbështetjen buxhetore, përcakton rezultatet e pritshme që lidhen me progresin në pritje në lidhje me kriteret e përshtatshmërisë dhe performancën në zbatimin e strategjisë kombëtare apo sektoriale mbi AFP-në. Këto rezultate mund të përfshijnë konsolidimin e stabilizimit makroekonomik, nxitjen e reformave sektoriale dhe menaxhimin financiar publik, etj. Në këtë kontekst, Dokumenti i Veprimit ka identifikuar tashmë objektiva konkrete që do të lidhen me sistemin e monitorimit të performancës dhe do të mbulojnë progresin e pritshëm në zbatimin e politikave kombëtare relevante, strategjive dhe procesit të reformës sektoriale.

Programi AFP do të mbështetet gjerësisht në objektivin specifik 2 të Dokumentit të Veprimit:

Të përmirësojë cilësinë dhe të rrisë mbulimin e Arsimit dhe Trajnimit Profesional

Për më tepër, Programi do të shënjestrojë objektivin specifik të Dokumentit të Veprimit:

Oferta e Arsimit dhe Formimit Profesional shtrihet në zonat rurale dhe në grupet më në nevojë

3.1.3 Protokoll i Italo-Shqiptar i Bashkëpunimit për Zhvillim 2014-2016

Partneriteti mes Shqipërisë dhe Italisë bazohet në marrëdhëniet e veçanta historike, kulturore dhe ekonomike. Organizata *Italian Development Cooperation* (IDC) (Bashkëpunimi Italian për Zhvillim) ka qenë i pranishëm në Shqipëri qysh prej vitit 1991, duke mbështetur zhvillimin social-ekonomik të vendit nëpërmjet programeve që synojnë të konsolidojnë sistemet prodhuese, të lidhin rrjetet rajonale të infrastrukturës, të nxisin menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve dhe të forcojnë kapacitetet institucionale si dhe shërbime sociale, arsimore dhe shëndetësore.

Angazhimi politik i Italisë në Shqipëri reflekton strategjinë në kuadër më të gjerë të Qeverisë Italiane në Ballkanin Perëndimor, që synon nxitjen dhe mbështetjen e Politikës së Zgjerimit të BE-së, vlerat demokratike të kundruara brenda saj, dhe mundësitë që krijohen lidhur me nxitjen e zhvillimit ekonomik e social. Për më tepër, Shqipëria konsiderohet si një vend prioritar në rajon për shkak të pozicionit të saj strategjik gjeopolitik dhe pozicionit pajtues e stabilizues treguar me vendet fqinjë në hapësirën më gjerë të makro-rajonit të BE-së Adriatik-Jon.

Dialogu mes qeverive italiane dhe shqiptare është koherent dhe i konsoliduar, dhe ushqehet nga marrëdhëniet intensive të bashkëpunimit dypalësh në shumë sektorë dhe sfera. Bazuar në këtë, qeveritë italiane dhe shqiptare kanë rënë dakord për një Protokoll të ri të Bashkëpunimit për Zhvillim që do të trajtojë tre shtylla të SKZHI dhe prioritete:

Rritje e Qëndrueshme nëpërmjet përmirësimit të konkurrueshmërisë dhe përdorimit eficient të burimeve, me vëmendje të veçantë në rritjen e Konkurrueshmërisë dhe Inovacionit për rritje në sektorët kyç të ekonomisë përfshirë në Bujqësi dhe Zhvillimin Rural;

Qeverisje e Mirë, Demokraci dhe Sundim i Ligjit. Duke njohur vlerën e parimeve europiane të subsidiaritetit dhe afërsisë së ofrimit të shërbimit të sektorit publik, IDC do të mbështesë reformën administrative territoriale të qeverisë shqiptare që është duke u realizuar me synimin për të fuqizuar Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV);

Investimi tek Njerëzit dhe në Kohëzëonin Social do të fokusohet kryesisht në zhvillimin e burimeve njerëzore, veprimeve në funksion të përfshirjes sociale dhe kohezionit territorial, ndër të cilat është rënë dakord për një alokim prej 5 milion euro (kredi e butë) për të mbështetur *Arsimin dhe Formimin Profesional nëpërmjet Inovacionit*. Në mënyrë specifike, Programi i financuar nga IDC do të fokusohet në mbështetjen e zgjerimit të një shoqërie të avancuar bazuar në dije, në përputhje me kërkesat e tregut të punës për të tërhequr IHD/IBD në sektorë produktivë ku, si Shqipëria ka një potencial të madh, edhe Italia ka një vlerë të shtuar të rëndësishme (d.m.th. përpunimin agro-ushqimor, agro-turizëm dhe turizëm, industri mode, mobileri, etj.).

3.3 Rezultatet

Në përfundim të kësaj Kontrate Binjakëzimi, do të arrihen rezultatet e mëposhtme:

Rezultati 1. Ndërtohet një plan veprimi afat-mesëm për një qendër AFP multifunksionale bazuar në kompetenca, në fushën e bujqësisë dhe industrisë agro-ushqimore

Duhet të zhvillojë konceptin e një Qendre AFP Bujqësore me qëllim multishërbim si dhe një koncept për një shkollë pilot bujqësore AFP. E gjithë puna për zhvillimin e kurrikulave duhet t'i kushtojë vëmendje një qasje partneriteti që të lehtësojë dhe koordinojë kontributin e palëve kryesore të interesit në AFP publike e private, sipas praktikave më të mira të PTAFP. MMSR dhe ekspertët e Binjakëzimit do të përcaktojnë planin e veprimit që do bihet dakord për zbatimin e Programit.

Rezultati 2. Në shkollën AFP në Fier realizohet një zbatim pilot i trajnimeve formale dhe jo formale, me një strategji për të siguruar një zbatim të qëndrueshëm, ndërsa në shkollën

AFP në Lushnjë realizohen ndërhyrje të posaçme.

Kontrata e Binjakëzimit e parashikuar do të përfshijë një eksperimentim në terren që synon të rregullojë cilësinë e Shkollës AFP Fier nëpërmjet një skeme pilot. Ky eksperimentim do të përgatitet në bazë të Dokumentit të Formulimit të Programit dhe do të verifikojë dhe zhvillojë gjetjet paraprake. Kurrikulat e reja dhe metodat e materialet mësimore zhvilluar nën këtë Rezultat, do të zbatohen në programe trajnimi përfshirë Programin formal të AFP-së si dhe ato me trajnime “jo formal” që kanë në fokus të rritur, punëkërkes, grupe në nevojë dhe persona me aftësi të kufizuara. Pritet gjithashtu që ky zhvillim të përdoret si një mundësi për të testuar qasjet e reja për aftësi dhe vlerësimin e të mësuarit të mëparshëm. Projekti i Binjakëzimit do të asistojë gjithashtu në rregullimin cilësor të shërbimeve të trajnimit, në identifikimin e marrëdhënies pilot me sektorin privat në industrinë agro-ushqimore. Një shembull mund të jetë Pakti Territorial AFP në Itali.

Tregues kyç për arritjet janë si më poshtë:

- Zhvillohen dhe testohen kurrikulat dhe materialet e trajnimit;
- Zhvillohen dhe zbatohen programe trajnimi formale dhe jo-formale;
- Përgatitet drafti për strategjinë e shkollës;
- Ndërtohet Pakti Pilot Territorial (PTAFP).

Rezultati 3. Trajtohen zhvilluesit e kurrikulave, menaxherët e shkollave dhe mësuesit me qëllim që të mbështesin zhvillimin e projektit të Binjakëzimit dhe të shpërndajnë/shtrijë efektet e tij.

Zhvillimi i projektit të Binjakëzimit do të jetë i mundur vetëm nëse mbështetet me asistencë trajnimi thelbësore dhe relevante gjithë stafi i përfshirë në këtë proces, si menaxherët e shkollave, mësuesit, zhvilluesit e kurrikulave, politikë-bërësit. Temat kryesore të trajnimit do të mbulojnë aspekte të ndryshme të procesit të përmirësimit të AFP, në veçanti: përgatitja e politikave, studime të tregut të punës, konceptimi i kurrikulave dhe standardeve profesionale, ndërtimi i partneriteteve në AFP, konceptimi i programeve të trajnimit dhe përgatitja e strategjisë së shkollës. Në bazë të eksperiencave të mëparshme, përfituesi kryesor po pret që, përveç seminareve me ekspertë ndërkombëtarë dhe vizitave studimore, transferimi i ekspertizës do të përfshijë edhe mundësi reale të gatshme për përdorim (“*hands on*”) për shembull: “Marrëdhënie binjakëzimi” mes shkollës/shkollave AFP dhe atyre italiane dhe/ose skema praktikash profesionale.

Tregues kyç janë si më poshtë:

- Trajnerët e mësuesve dhe mësuesit në dy shkollat të njihen me metodën moderne të mësimdhënies;
- Kryhet të mësuarit dhe vlerësimi;
- Administratorët dhe mësuesit e shkollave njihen me trajnimin AFP me bazë kompetencat;
- Standarte të reja kualifikimi, kurrikula, materiale trajnimi dhe të të mësuarit për profesionet në sektorin e bujqësisë;
- Vizitë studimore.

Rezultati 4. Sigurohet koherence me financimin IPA II për Sektorin e Punësimit dhe Aftësive

Me qëllim që të sigurohet koherence me Mbështetjen Buxhetore IPA II për Sektorin e Punësimit dhe Aftësive, në lidhje me komponentin AFP, Institucioni do të ofrojë asistencë teknike të specializuar për të: i) siguruar përputhshmërinë e Programit me Dokumentin e Veprimit mbi Punësimin, Aftësitë dhe Përfshirjen Sociale; ii) mundësuar, në sinergji të drejtpërdrejtë dhe koordinim me GMIP dhe grupet tematike që lidhen më të dhe sekretariatit, mbështetje në nivel të lartë lidhur me politikat për MMSR-në për sa i përket zbatimit dhe monitorimit të SKPA.

3.4 Aktivitetet:

Projekti i Binjakëzimit nuk duhet të jetë një asistencë teknike njëdrejtimëshe, ai duhet të ndihmojë të prezantohet dhe të ndahet mes palëve praktikant e mira në lidhje me fushën e përmirësimeve të

AFP-së dhe mundësive për vende pune. Asistenca e Binjakëzimit do të sigurohet në formën e transferimit të ekspertizës, dhe do të përcillet nëpërmjet:

- *Këshillime dhe sesione asistimi*: Aktivitetet e këshillimit dhe asistimit do të jenë tipi predominant i aktivitetit. Këto do të ndihmojnë për një përshtatje më të saktësuar e specifike të ndërtimit të një strategjie të duhur.

- *Programe trajnimi përshtatur sipas kushteve specifike*: Do të organizohen trajnime specifike për administratorët e shkollave.

- *Seminare, prezantime pune, konferenca*: programi i trajnimit do të përfshijë organizim seminaresh prezantime pune, konferenca etj.

- *Manuale, procedura dhe lista kontrolli*: Partneri i Binjakëzimit duhet të shqyrtojë dhe rishikojë kurrikulat ekzistuese dhe të propozojë të reja, atje ku kjo është relevante. Kjo detyrë do të bëhet në bashkëpunim të ngushtë dhe konsultim me stafin kyç të shkollave të përfshira.

- *Vizita studimore*: Nëse është relevante, do të organizohen vizita studimore për nxënës dhe mësues të shkollave.

Ndarja e eksperiencës

Ndarja e eksperiencës është thelbësore. Për këtë janë parashikuar aktivitete specifike.

Vlerësimi

Çdo aktivitet dhe program trajnimi do të vlerësohet. Rezultatet do të përpilohen dhe prezantohen tek Komiteti Drejtues. Atje ku është relevante, dhe e mundur, do të vlerësohen aktivitete të tjera të projektit të binjakëzimit në mënyrën më relevante.

Aktivitetet specifike mund të përfshijnë:

- i. Identifikimi i pajisjeve të laboratorit dhe infrastrukturës;
- ii. Zhvillimi dhe testimi i kurrikulave;
- iii. Asistencë për menaxhimin e shkollave të AFP;
- iv. Asistencë për sigurimin e cilësisë dhe akreditimin e BE;
- v. Tërheqja e ndërmarrjeve italiane në bujqësi dhe përpunimin agro-ushqimor për të marrë pjesë në Bordin e Shkollës dhe në PTAFP;
- vi. Asistencë për konceptimin e projektit dhe menaxhimin (Programi “European Social Fund” dhe Erasmus+);
- vii. Trajnimi i trajnerëve;
- viii. Asistencë për ngritjen dhe funksionimin e PTAFP;
- ix. Asistencë për menaxhimin e ndërmarrjes bujqësore;
- x. Asistencë për identifikimin e programeve/projekteve speciale për nxënës në nevojë.

3.5 Mjetet/ Inputet nga Administrata e Partnerit Institucional:

Asistenca e binjakëzimit do të bazohet në katër komponentë kryesorë: i) Drejtuesi i Projektit; ii) Këshilltari Rezident i Binjakëzimit; iii) ekipi i Koordinimit të Projektit; iv) ekspertët afat-shkurtër

3.5.1 Profili dhe detyrat e Drejtuesit të Projektit

Drejtuesi i Projektit duhet të jetë një ekspert i rangut të lartë i Institucionit, me njohuri të gjera në fushën e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe punësimit dhe duhet të ketë aftësi të shquara drejtimi e udhëheqje dhe eksperience menaxheriale të konsoliduar. Drejtuesi i projektit duhet të jetë i gatshëm të punojë në bazë të përditshme në ambientet e shkollave në Fier dhe Lushnjë.

Detyrat:

1. Të kryejë zbatimin e përditshëm të projektit të Binjakëzimit në Rajonin e Fierit;
2. Të garantojë zbatimin e lehtë dhe pa pengesa të planit të punës;
3. Të sigurojë koherencën dhe vazhdimësinë e inputeve të njëpasnjëshme dhe progresin përgjatë rrjedhës;
4. Të vlerësojë në vijimësi projektin e Binjakëzimit në të gjitha fazat dhe ta krahasojë me kuadrin kohor të rënë dakord;

5. Të sigurojë mbështetje, këshillim teknik dhe të asistojë shkollat e AFP-së në kontekstin e një plani punë të parapërcaktuar.

3.5.2 Profili dhe detyrat e Këshilltarit Rezident të Binjakëzimit

Këshilltari Rezident i Binjakëzimit duhet të jetë një ekspert i rangut të lartë i Institucionit, me njohuri të gjera në fushën e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe politikave të BE-së për punësimin.

Detyrat:

1. T'i japë MMSR-së këshillim për politikën në lidhje me zbatimin e SKPA 2014-2020;
2. T'i japë MMSR-së këshillim për politikën në lidhje me zbatimin e Dokumentit të Veprimit të BE-së 2014-2020;
3. Të monitorojë procesin e gjithanshëm të zbatimit të SKPA 2014-2020.

3.5.3 Profili dhe detyrat e ekipit të koordinimit të Projektit

Brenda ekspertizës së kërkuar për zbatimin e projektit, mund të nevojiten profilet e mëposhtme, me bazë në Fier dhe Lushnjë: Asistent projekti, Oficer Financiar dhe Administrativ, Teknik/Agronom, oficer për ndërlidhjen mes Shkollës – Ndërmarrjes, Përkthyes, Shofer/Asistent Logjistike.

3.5.4 Profili dhe detyrat e ekspertëve afat-shkurtër (EASH)

Brenda ekspertizës së kërkuar për zbatimin e projektit, mund të nevojiten profilet e mëposhtme:

Personel tjetër specialistësh do të mundësohen nga Partneri i Binjakëzimit për të mbështetur zbatimin e aktiviteteve. Çështje specifike dhe teknike që nuk mbulohen direkt nga ekipi i koordinimit të projektit, mund të merren përsipër nga ekspertë afat-shkurtër.

4. Buxheti

Buxheti për projektin bazohet në partneritet binjakëzimi 36 mujor.

Buxheti për projektin është 1.285.000,00. Euro

5. Marrëveshja për zbatimin

5.1 Agjencia Zbatuese për tenderim, kontraktim dhe kontabilitet

MMSR përgjigjet për tenderim, kontraktim, pagesat, kontabilitetin dhe mbikëqyrjen e gjithanshme të zbatimit të projektit.

5.2 Kontratat

Parashikohet një (1) Kontratë Binjakëzimi për zbatimin e aktiviteteve të sipërpërmendura.

6. Grafiku i Zbatimit (dëftues)

6.1 Fillimi i thirrjeve për propozime (Data)

Data për fillimin e thirrjeve për propozime është:

6.2 Fillimi i aktiviteteve të projektit (Data)

Fillimi i aktiviteteve të projektit planifikohet paraprakisht për:

6.3 Përfundimi i projektit (data)

Periodha e zbatimit të projektit (kohëzgjatja e planit të punës) do të përmbyllet për 36 muaj pas datës së fillimit të Projektit.

7. Qëndrueshmëria

Përmirësimi i kapaciteteve të MMSR për të zhvilluar punësimin dhe aftësitë për krijimin e vendeve të punës, do të mbështesë një vendim-marrje më efektive. Ndërtimi i rregullimeve/përcaktimeve për vlerësimin e rezultateve të programeve të AFP-së dhe kapacitetit për parashikim afat-gjatë, do të mbështesë konceptimin e politikave të arsimit dhe të punësimit të shënjestruar dhe kapërcimin me sukses të problemeve strukturore.

8. Ndjekja e rrjedhës

Tregues do të jenë si më poshtë:

1. Aprovimi i procesit të tenderimit për Binjakëzimin;
2. Përfundimi me sukses i kërkimit të një partneri për Binjakëzimin;

3. Nënshkrimi i Kontratës së Binjakëzimit, përfshirë dhe Planin e Punës së Binjakëzimit;
4. Fillimi i partneritetit të binjakëzimit (ndër të tjera, mbërritja e Këshilltarëve Rezidentë të Binjakëzimit);
5. Fundi i periudhës së zbatimit;
6. Paraqitja e raportit final.